



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

**RAPORT**  
**I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK**

**Programi i Studimit me karakter Profesional  
në “Eficiencë Energjitike”  
Universiteti “Polis”**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof. Dr. Aida Spahiu

PhD. Erald Piperi

Korrik/2021

## TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT

### Për Programin e studimit jouniversitar me karakter profesional në "Eficiencë Energjitike"

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti "POLIS"
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Kërkimit të Aplikuar (Fakulteti i Kërkimit dhe Zhvillimit) <sup>1</sup>
3	Emërtimi i programit të studimit:	Program studimi jouniversitar me karakter profesional në "Eficiencë Energjitike"
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	UMASh Nr. 315 datë 21.07.2014 <sup>2</sup>
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Urdhëri i regjistrimit të Formës së diplomës:	Urdhër MASR Nr. 170, datë 10.09.2020 <sup>3</sup>
7	Urdhëri/VBA i akreditimit pararendës:	UMASR Nr.242, datë 17.06.2015 (Sipas VKA Nr. 31, datë 27.03.2015)
8	Cikli i studimit:	Program studimi jouniversitar me karakter profesional, mbi shkollën e mesme
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite
10	Kreditet në total (ECTS):	120 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	Programi nuk ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera
13.1	• Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
13.2	• Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
14	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 5
15	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	6 PAE/4 PAK (60/40%)
16	Numri i studentëve (për brezin e fundit):	42
17	Komente / të tjera:	

<sup>1</sup> Në Urdhërin e licencimit ky program është hapur pranë Fakultetit Planifikim, Mjedis dhe Menaxhim Urban

<sup>2</sup> Programi ofrohet nga Universitetit "Polis", në kuader të projektit Tempus m.543782-tempus-1-2013-1-AL-Tempus-JPCR.

<sup>3</sup> Urdhëri nr. 112, datë 16.07.2018 për regjistrimin e formës së diplomës është shfuqizuar

## TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR PROGRAMIN E STUDIMIT NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Universiteti Polis është institucion i arsimit të lartë jo publik, i cili është licencuar me VKM Nr. 698, datë 11.10.2006 si shkollë e lartë universitare, jopublike "Universiteti Polis".

Me VKM nr. 746, datë 24.10.2012 miratohet ndryshimi i statutit nga "Shkollë e Lartë Universitare" në "Universitet".


Universiteti "Polis" është riakredituar me Vendimin e bordit të Akreditimit, VBA Nr. 113, datë 15.12.2017, me kohëzgjatje 6 vite, deri më 14.12.2023.

Universiteti "Polis" përbëhet nga 3 fakultete dhe 1 Qendër Studimore:

1. Fakulteti Arkitekturë dhe Dizajn
2. Fakulteti Planifikim, Mjedis dhe Menaxhim Urban
3. Fakulteti për Kërkim dhe Zhvillim
4. Qendra Studimore Ndërdisciplinore Kërkimore e Inovacionit

Program studimi jouniversitar me karakter profesional në "Eficiencë Energjitike" është hapur me UMASH Nr. 315 datë 21.07.2014, me kohëzgjatje 2 vite, 120 kredite. Programi ofrohet nga Universiteti "Polis", në kuader të projektit Tempus *m.543782-tempus-1-2013-1-AL-Tempus-JPCR*.

Programi i studimit mbështetet nga Departamenti i Kërkimit të Aplikuar, Fakulteti i Kërkimit dhe Zhvillimit. Ai është akredituar për herë të parë me **Urdhër të MASR Nr.242, datë 17.06.2015**, në përputhje me Vendimin nr. 31, date 27.03.2015 të Këshillit të Akreditimit të Arsimit të Lartë, për 6 vite.



## SHKALLA E PËRMBUSHJES SË REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I PARË

**Nuk ka rekomandime nga akreditimi i parë**

### PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Procesi i vlerësimit të jashtëm për akreditimin e programit të studimit profesional në “Eficiencë Energjitike” të ofruar nga Departamenti i Kërkimit të Aplikuar dhe njësia kryesore Fakulteti për Kërkim dhe Zhvillimit, filloi me prezantimin si dhe ndarjen e punës ndërmjet ekspertëve të grupit të vlerësimit të jashtëm. Ekspertët e jashtëm të këtij vlerësimi janë:

Prof.Dr Aida Spahiu

PhD. Erald Piperi

Grupi i vlerësimit të jashtëm, GVJ, bazuar në dokumentacionin e vendosur në dispozicion nga ASCAL, shqyrtoi Raportin e vlerësimit të brendshëm të hartuar nga Institucioni si dhe dokumentet përkatëse në mbështetje të tij. Gjatë kësaj faze u identifikuan dhe u listuan një sërë gjetjesh, që kishin lidhje me standardet dhe kriteret përkatëse dhe ju kërkua Institucionit që të vendoste materiale shtesë në sistemin AMS.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm, në dakortësi edhe me Universitetin Polis realizoi takimet e përcaktuara në axhendën e vizitës në IAL, në datën 27 Prill 2021. Në këtë vizitë në Institucion, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm u takua në takime të veçanta me: Dekanin e Fakultetit dhe Drejtuesin e Departamentit, Grupin e vetëvlerësimit, stafin akademik të programit të studimit, Drejtorinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, sekretarinë mësimore, Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, intervistë me studentët, vëzhgimi i mjediseve të institucionit si: auditorë, laboratorë, shërbimet për studentët etj.,

Gjatë takimeve u bënë pyetje të ndryshme që lidhen me vlerësimin e programit të studimit në fjalë, duke sqaruar edhe elementë të veçantë.



Pas vizitës në Universitetin Polis, GVJ filloi punën për të hartuar raportin e vlerësimit të jashtëm bazuar në dokumentacionin në dispozicion dhe informacionin e mbledhur gjatë takimeve dhe dhe të kërkuara në këtë Institucion. Në përfundim të këtij procesi ky grup dorëzon draft-raportin tek eksperti përkatës i ASCAL.

Grupi i ekspertëve të jashtëm është asistuar nga Specialisti i ASCAL Renata Qatipi.

Me datë 06.07.2021, nëpërmjet AMS dhe me shkresë zyrtare Nr. 47/15 Prot, datë 06.07.2021 “Njoftim për dërgimin e Draft Raportit të vlerësimit të jashtëm”, Universiteti POLIS është njohur me Draft Raportin e vlerësimit të jashtëm, hartuar nga GVJ.

Universiteti POLIS më datë 15.07.2021, përcjell përgjigjen për Draft RVJ, nëpërmjet AMS dhe me shkresë Nr. 613/21 Prot, datë 13.07.2020. Në këtë shkresë Institucioni deklaroi se, në përgjithësi, është dakort me Draft RVJ.

Në këtë rast Draft Raporti kthehet në Raport përfundimtar





## Vlerësimi i Programit të Studimit me karakter profesional në “Eficiencë Energjitike”

### I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL

<b>Standardi I.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi me karakter profesional në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij dhe në përputhje me nevojat e kërkesat e tregut të punës.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<b>Kriteri 1.</b> Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.	<p>Në statutin e institucionit deklarohet se “UPolis ka mision ..... Të ndihmojë zhvillimin ekonomik në nivel rajonal, kombëtar e vendor”;</p> <p>Nga RVB citohet: “Çështjet e energjisë, burimeve të saj si dhe konsumit janë mjaft koherente në nivel kombëtar si dhe ndërkombëtar. Për rrjedhojë nga qëllimet kryesore të këtij programi konsiston në edukimin e studentëve me aftësi praktike në këto fusha duke ju përgjigjur dhe përshtatur më së miri kërkesave të tregut në fushën e energjisë.</p> <p>GVJ konstaton se Programi i studimit me karakter profesional “Eficiencë Energjitike” është hartuar dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e Institucionit, gjë e cila reflektohet në Statutin e Universitetit Polis, neni 2, Vizioni, dhe neni 3, Misioni, si dhe në strategjinë e Polis 2020 – 2024.</p> <p>Statuti Polis; Strategjia 2020-2024.</p>
<b>Kriteri 2.</b> Statuti dhe rregullorja e institucionit duhet të përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike të tij dhe të demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.	<p>Në statutin dhe Rregulloren e Universitetit “Polis”, neni 3, Misioni, pika 2 c) përcaktohet qartë se Universiteti “Polis” ka objektiv të ofroj studime në nivel të diplomës profesionale, Bachelor, Master dhe Doktoratë.</p> <p>Neni 1, pika 1 e Statutit dhe Rregullore shprehet se: Universiteti Polis ka karakter akademik, kërkimor shkencor, aplikativ me programe në të katër nivelet e mësimdhënies, nivelet 5-8 të kualifikimit sipas KSHK.</p> <p>Në nenet 34, 35 dhe 36 të statutit dhe rregullore demonstron qartë që ky program studimi është drejtim prioritar i Institucionit.</p> <p>Statuti dhe Rregullore e Përgjithshme Polis</p>
<b>Kriteri 3.</b> Programet e studimeve ofrohen në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit, si dhe fushën akademike të njësisë kryesore/kolegjit profesional dhe atë të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit.	<p>GVJ konstaton se programi i studimit me karakter profesional në “Eficiencë Energjitike” ofrohet në përputhje me fushat e drejtimit akademike të Universitetit “Polis” (Rregullore e përgjithshme e Polis, neni 34, Diploma Profesionale).</p> <p>Ky program studimi ofrohet nga Fakulteti për Kërkim dhe Zhvillim, FKZH, i cili gjithashtu ofron programet e studimit si më poshtë:</p> <ol style="list-style-type: none"><li>1. Diplomë profesionale në “Eficiencë Energjitike”</li><li>2. Diplomë profesionale në “Mirëmbajtje Rrjete Kompjuterike”</li><li>3. Bachelor në “Shkenca Kompjuterike”</li><li>4. Doktoratë në “Arkitekturë dhe Planifikim Urban”</li><li>5. Program/Kurs i Formimit të Vazhduar “Auditues Energjistik”.</li></ol>

5

	<p>Departamenti i Kërkimit të Aplikuar (DKA) që mbështet këtë program studimi ofron dy Programe të studimit me karakter profesional, dy vjeçare:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Diplomë profesionale në “Eficiencë Energjitike”</li> <li>2. Diplomë profesionale në “Mirëmbajtje Rrjete Kompjuterike”</li> </ol> <p>Rregullore e Përgjithshme Polis Rregullorja e FKZH, neni 12</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Propozimi, hartimi dhe realizimi i programit të studimit me karakter profesional mbështetet në studime të mirëfillta mbi tregun lokal e kombëtar të punësimit për këto programe.</p>	<p>Burimet e energjisë së rinovueshme dhe efienca e energjisë janë dy drejtimet kryesore ku qeveria shqiptare ka vënë fokusin sot, në mënyrë që të rritet siguria e furnizimit me energji elektrike ne Shqipëri dhe të ulen importet e energjisë elektrike.</p> <p>Institucioni ka një studimi tregu të përgjithshëm, në gjuhën angleze, në lidhje me këtë program studimi, material i vendosur në sistem pas kërkesës së ekspertëve.</p> <p>GVJ bazuar në takimet me drejtuesit konstatoi se ky program studimi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Formon profesionistë të fushës që mund të orientohen lehtë dhe janë fleksibël në tregun e punës.</li> <li>- Të diplomuarit e këtij programi synohet të punësohen në kompanitë apo ndërmarrjet private që ofrojnë shërbime në eficiencë energjitike por punojnë edhe të pavarur, duke ofruar shërbime në fushën e eficiencës energjitike.</li> <li>- Të diplomuarit e këtij programi, falë njohurive që përfitojnë, mund dhe marrin pjesë në procesin e auditimit energjistik. Ata mund të ofrojnë shërbime instalimi dhe mirëmbajtje të sistemeve të ndryshëm HVAC.</li> </ul> <p>Minutat e takimeve në Institucion Studimi i tregut EE.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Gjatë realizimit të programit të studimit, nga pranimi në diplomim dhe pas daljes së studentëve në punë, zhvillohen studime periodike mbi tregun e punës, ndryshimet përkatëse dhe punësimin e studentëve.</p>	<p>Institucioni ka kryer gjatë realizimit të programit të studimit një studim, më 28 Shkurt 2018 në lidhje me nevojën për teknik të eficiencës energjitike në ndërtesa, dokument i vënë në dispozicion gjatë vizitës në Institucion, evidence 2, Studim periodik, vizita në institucion.</p> <p>Në këtë studim konstatohet se: <i>sasia e ndërtesave pa izolim të duhur termik në Shqipëri po rritet vazhdimisht së bashku me zhvillimin informal të vendbanimeve në projektin dhe ndërtimin joadekuat procedurat. Konsumi i energjisë në banesa në Shqipëri përbën 26% të energjisë totale, konsum, i cili është më i ulët se sa shifrat në vendet e BE (ku pothuajse 40% e energjisë përdoret në ndërtesa). Pavarësisht këtij fakti, emetimi i CO<sub>2</sub> në Shqipëri është akoma më i lartë se në BE dhe vendet e tjera të zhvilluara, kryesisht për shkak të pranisë së izolimit termik të pakët dhe keqpërdorimi i energjisë. Shifrat e mësipërme tregojnë se ka mundësi të mëdha për të arritur një përmirësim i dukshëm në çështjet e konsumit të energjisë dhe si pasojë për të arritur kursime të larta të energjisë.</i></p> <p>Pra tregu ka nevojë për këtë profesion. Në dosjen e vetvlerësimit, DVV, janë të vendosur dhe studime nga UNDP mbi programet profesionale të arsimit të mesëm.</p>

	<p>Universiteti "Polis" ka nënshkruar një memorandum bashkëpunimi me Swiss Contact, në kuadër të projektit "Aftësi për punë" për mbështetjen e praktikave profesionale dhe metodave të reja të mësidhënies, për këtë program studimi të nivelit 5, evidence 6 në dokumentat e vizitës në institucion. Me anë të këtij memorandum synohet që të krijohen kushtet që studentët të mbështeten financiarisht gjatë zhvillimit të praktikës.</p> <p>Në dosjen e vetvlerësimit, DVV nuk ka të dhëna mbi punësimin e studentëve, megjithëse janë diplomuar 5 breza studentësh nga ky program studimi.</p>			
<p><b>Kriteri 6.</b> Studimet paraprake dhe periodike të tregut të punës për programet me karakter profesional duhet të përfshijnë të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>	<p>Në RVB dhe gjatë takimeve në institucion është theksuar fakti që gjatë komunikimeve zyrtare me kompani që operojnë në fushën e eficiencës energjitike, është konstatuar se pjesa më e madhe e tyre vuajnë nga mungesa e një stafi të arsimuar dhe trajnuar në nivel profesional e praktik, në përshtatje me shërbimin që ato presin e dëshirojnë të ofrojnë. Në këtë aspekt, programi i vjen në ndihmë sipërmarrjes private.</p> <p>GVJ konstaton se në studimin paraprak dhe atë periodik të tregut për këtë program studimi nuk janë përfshirë të dhëna nga komunikimi zyrtar me kompanitë, me të cilat ka marrëveshje bashkëpunimi, në lidhje me kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve apo të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar.</p> <p>Evidencë Studimi i tregut EE; Evidence Studim periodik, vizita në institucion.</p> <p>Në DVV dhe në site-n zyrtar të Universitetit "Polis" është e vendosur lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit me Institucione të tjera të arsimit të lartë brenda dhe jashtë vendit si dhe kompani të ndryshme me të cilat ka bashkëpunim. Aneksi 7.</p>			
<b>Shkalla e përbushjes së standardit</b>		<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>
				X

### Standardi I.2

**Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit dhe me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, dhe në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.**

Kriteret	Vlerësimi
<p><b>Kriteri 1.</b> Për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësiive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>Programi me karakter profesional "Eficiencë Energjitike" është hartuar nga Universiteti "Polis" në kuadër të projektit <i>TEMPUS-JPCR-543782-2013-AL "Developing an adapting professional program for energy efficiency in the Western Balkans"/DAPEEWB (2013-2017)</i>. Departamenti Kërkimit të Aplikuar (DKA), pranë Fakultetin për Kërkim dhe Zhvillim, FKZH është përgjegjës për këtë program studimi me karakter profesional.</p> <p>Departamentet e FKZH bashkëpunojnë me njëra tjetrën dhe me bashkëpunëtorë të jashtëm për zhvillimin dhe mbarëvajtjen e procesit mësimor në këtë program studimi, evidencë, Aneksi 19, lista e stafit të angazhuar në EE.</p>

	Dekanati i FZHK bashkërendon punën ndërmjet njërive bazë për marrjen e përgjegjësisë në realizimin e mësimit dhe analizën e punës.
<b>Kriteri 2.</b> Për realizimin e objektivave të procesit mësues, formimin teorik e praktik të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie afatgjata e të qëndrueshme bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, me punëdhënës vendës, aktorë të biznesit vendës dhe/ose të huaj.	<p>Mbështetur në DVV dhe RVB, GVJ konstaton se për realizimin e objektivave të procesit mësues, formimin teorik e praktik të studentëve për këtë program studimi me karakter profesional, Universiteti "Polis"</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- ka vendosur marrëdhënie afatgjata e të qëndrueshme bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe jashtë vendit, kompani të ndryshme për realizimin e praktikave profesionale, si dhe është i anëtarësuar në rrjete akademike dhe shoqata;</li> </ul> <p>Evidence Aneksi 7, Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit.</p> <p>Do të ishte me interes për këtë program studimi që Universiteti Polis të kishte marrëveshje bashkëpunimi me Universitetin Politeknik të Tiranës që ka disa programe studimi në drejtimin e eficiencës së energjisë.</p>
<b>Kriteri 3.</b> Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.	<p>Programi profesional i studimit "Eficiencë Energjitike është hapur për herë të parë në vitin akademik 2013-2014, me UMASH Nr. 315 datë 21.07.2014, me kohëzgjatje 2 vite akademike, me 120 kredite.</p> <p>GVJ, mështetur në RVB dhe dosjen e Vetëvlerësimit konstaton se, GVB nuk ka dhënë informacion në lidhje me hartimin e raporteve analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të këtij programi studimi.</p> <p>Aneksi 1, Vendim Licensimi EE; Aneksi 28. Të dhëna statistikore për studentët e regjistruar; Aneksi 22- kalendari i praktikave, Studimi i tregut EE; Studim periodik; vizita në institucion.</p>
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimeve që ofrojnë.	<p>Universiteti "Polis" ka vendosur marrëdhënie zyrtare dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programit të studimit.</p> <p>Aneksi 7, Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit.</p> <p>GVJ mendon se Universiteti duhet të kishte dhënë në Dosjen DVV, jo vetëm listen e bashkëpunimeve por dhe marrëveshjet konkrete të bashkëpunimit, të cilat do të na jepnin një informacion të plotë për nivelin e bashkëpunimit me kompanitë.</p> <p>Aneksi 22, Kalendari i praktikave, për semestrin e dytë.</p>
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni ndërmerr iniciativa specifike në mbështetje të sipërmarrjes dhe punësimit të studentëve.	<p>GVJ, mbështetur në RVB dhe dosjen e Vetëvlerësimit konstaton se prej vitit 2009, Universiteti POLIS ka në strukturë Zyrën e Mbështetjes së Studentëve dhe Këshillimit të Karrierës (ZMSKK). Detyrat dhe funksionet kryesore të kësaj njësi janë informimi i studentëve përpara dhe gjatë ndjekjes së studimeve, njohja paraprake me tregun e punës, orientimin e tyre në këtë treg si dhe ndërmjetësimi e lehtësimi i procesit të punësimit, aty ku është e mundur, për më shumë mbi detyrat e zyrës. Në përfundim të ciklit të tyre 2-vjeçar të studimeve studentët përfitojnë këshillim nga zyra, por edhe nga stafi i angazhuar në mësime në këtë program sepse ata janë të angazhuar në kompani të fushës, iu ofrojnë vazhdimisht këshillim dhe orientim efektiv</p>




	<p>studentëve lidhur me hapësirat, kërkesat dhe mundësitë e punësimit, si edhe vetë punësimit.</p> <p><a href="http://www.universitetipolis.edu.al/?q=sq/node/57">http://www.universitetipolis.edu.al/?q=sq/node/57</a></p> <p>Universiteti POLIS ndërmerr iniciativa në mbështetje të sipërmarrjes dhe punësimit të studentëve. Një iniciativë e fundit është ajo me Swiss Contact, ku synohet që kompani të ndryshme të kontaktojnë direkt me studentët nëpërmjet takimeve të hapura informative.</p> <p>MoU Polis-Swiss, vizita në Institucion.</p> <p>Universiteti POLIS është pjesëmarrës i projektit GRADUA, i cili synon të krijojë ura të drejtpërdrejta lidhjeje të studentëve me kompanitë dhe punëdhënësit, evidencë <a href="https://www.graduaproject.com/">https://www.graduaproject.com/</a></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X


### Standardi I.3

**Programet e studimeve organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi dhe Kuadrin Evropian e Shqiptar të Kualifikimeve për këto programe studimi.**

Kriteret	Vlerësimi
<p><b>Kriteri 1.</b> Programet e studimeve janë të organizuara në lëndë/module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Programi i studimit me karakter profesional “Eficiencë Energjitike” është i organizuar me lëndë, të cilat janë të ndara në kredite, leksione, seminare, ushtrime dhe laboratore, në përputhje me Ligjin 80/2015 dhe VKM 41 datë 24.01.2018, “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, VKM Nr. 879, datë 18.12.2019 “Disa ndryshime dhe shtesa në VKM Nr. 41 datë 24.01.2018”.</p> <p>Programi i studimit është i organizuar me kredite ECTS në përputhje me sistemin Evropian të transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve. Matrica EE.</p> <p>Programi organizohet në dy vite akademike (4 semestra) me 120 kredite, dhe karakterizohet nga veprimtaritë formuese të grupuara në: a) Lëndë bazë, b) Lëndë karakterizuese, c) Lëndë ndërdisiplinore dhe/ose integruese, d) Lëndë plotësuese, e) Detyrime përmblylëse. Aneks 8 Rregullore e programit të studimit, neni 3 dhe neni 5</p> <p>Programi i studimit me karakter profesional në “Eficiencë Energjitike” është riorganizuar në vitin akademik 2020-2021, mbi masën 20%, evidence Matrica EE.</p> <p>Në ndryshim nga planet mësimore të viteve 2015-2020, në planin mësimor të ndryshuar dhe të miratuar për 2020-2022 ka ndryshim kreditesh në shumicën e lëndëve dhe është futur një lëndë e re, <i>Aplikacione Informatike</i>.</p> <p>Në DVV, GVJ nuk gjeti ndonjë material në lidhje me propozimin e njësisë bazë, me argumentet përkatëse për këto ndryshime, Vendimin e Senatit të Universitetit POLIS për miratimin e ndryshimeve të planit mësimor për këtë</p>



9



	<p>program studimi. Gjithashtu nuk ka dokument në sistemin AMS për aprovim të këtyre ndryshimeve nga MASR, evidencë Aneks 48 Miratim kurrikule.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programet e studimeve me karakter profesional synojnë përfundimin e njohurive gjithë përfshirëse të specializuara teorike dhe praktike brenda një fushe punësimi në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh.</p>	<p>Programi me karakter Profesional në “Eficiencë Energjitike” i Universitetit POLIS synon të japë njohuri formuese dhe praktike bazë mbi çështje dhe fenomene që lidhen me eficiencën e energjisë në përgjithësi dhe veçanërisht me eficiencën në banesa, të cilat kanë dhe konsum të lartë të energjisë në vendin tonë, evidence Aneks 8 Rregullore e programit të studimit.</p> <p>Në planin mësimor përfshihen lëndë si: <i>Aplikacione informatike, Teknologji Arkitekture dhe ndërtimi, sisteme HVAC, Energjitë e rinovueshme, Menaxhim biznesi</i>, të cilat synojnë përfundimin e njohurive gjithë përfshirëse të specializuara teorike dhe praktike brenda një fushe punësimi. Matrica EE.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programet e studimit me karakter profesional synojnë pajisjen e studentëve me një sërë aftësish njohëse dhe praktike gjithëpërfshirëse që nevojiten për të zgjidhur në mënyrë krijuese probleme të karakterit profesional praktik.</p>	<p>Programi i studimit me karakter profesional në “Eficiencë Energjitike” synon të përgatisë studentët me një sërë aftësish njohëse dhe praktike në një fushë të rëndësishme si ajo e përdorimit të energjisë me leverdi ekonomike në banesa, evidence Aneks 8 Rregullore e programit të studimit.</p> <p>Nëpërmjet koncepteve tekniko ekonomike është tentuar të vendoset një model ndërtese me përdorim të ulët të energjisë nëpërmjet metodave të izolimeve termike dhe përdorimit të materialeve eficientë në ndërtim dhe në impiantin energjetik të banesës.</p> <p>Evidence: Aneks 8 Rregullore e programit të studimit.</p> <p>Programi i studimit me karakter profesional në “Eficiencë Energjitike” ka në planin mësimor lëndë të formimit praktik si: <i>Praktikë Laboratorike, Mirëmbajtje, Intership, Kode dhe Standarde Europiane dhe lokale në eficiencë Energjitike</i>. GVJ i është referuar planit mësimor të ndryshuara për vitin akademik 2020-2022, pasi ato janë planet aktuale në fuqi.</p> <p>Tabelat përmbledhëse ASCAL, vizita në Institucion.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programet e studimit me karakter profesional synojnë zhvillimin e kompetencave për menaxhimin dhe mbikëqyrje në kuadrin e veprimtarive profesionale dhe orientimin e duhur në situata të ndryshme e të ndryshueshme.</p>	<p>Programi i studimit me karakter profesional “Eficiencë Energjitike” ka lëndë, të cilat synojnë zhvillimin e kompetencave për menaxhimin dhe mbikëqyrje në kuadrin e veprimtarive profesionale dhe orientimin e duhur në situata të ndryshme si: Menaxhim Biznesi, Mirëmbajtje, Instalime dhe Rregullat e sigurisë. Evidence: Matrica EE.</p> <p>Sic u diskutua edhe në takim me Dekanin e FZHK dhe drejtuesin e Departamentit, <i>përmes koncepteve teknike që janë pjesë e njohurive të lëndëve të programit, synohet formimi i një figure profesionale me kompetencat e duhura për menaxhimin edhe mbikëqyrjen teknike të veprimtarive në fushën e Eficiencës Energjitike në ndërtesa.</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni/njësia kryesore/kolegji profesional dhe njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë të organizimit, strukturës akademike dhe numrit e shkallës së kualifikimit të stafit akademik.</p>	<p>Universiteti Polis është institucion jopublik i arsimit të lartë. Në përputhje me nenin 18, të ligjit 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Universiteti përfaqëson një strukturë të integruar dhe të përbërë nga njësi kryesore, njësi bazë dhe njësi të tjera, sipas përcaktimeve të statutit të institucionit. Universiteti Polis ka tre Fakultete dhe një Qendër studimore dhe kërkimore:</p>

1. Fakulteti Arkitekturë dhe Dizajn
2. Fakulteti Planifikim, Mjedis dhe Menaxhim Urban
3. Fakulteti për Kërkim dhe Zhvillim
4. Qendra Studimore Ndërdisciplinore Kërkimore e Inovacionit

Rektori i Universitetit Polis mban titullin “Profesor” në përputhje me nenin 39, pika 3 të ligjit 80/2015, datë 22.07.2015.

Dy Dekanë të Universitetit Polis, perkatesisht dekani i Fakultetit të Arkitekturës dhe Dizajn si dhe dekani e Fakultetit për Kërkim dhe Zhvillim janë me gradën PhD. Ligji 80/2015, neni 42, pika 3, përcakton se drejtuesi i njësisë kryesore është personel akademik i kategorisë “Profesor”.

Njësia kryesore që mbështet këtë program studimi është FKZH, e cila ka në përbërje dy departamente dhe një qendër:

1. Departamenti i Kërkimit Shkencor
2. Departamenti i Kërkimit të Aplikuar
3. Qendra Kërkimore e Qëndrueshmërisë

Në përputhje me neni 23, pika 2, të ligjit 80/2015, datë 22.07.2015: Fakulteti organizohet në së paku tri njësi bazë, së paku dy prej të cilave janë departamente.


Për vitin akademik aktual 2020-2021, FZHK ka në përbërjen e tij, 36 pedagogë si personel akademik të ndarë në 24 PAE dhe 12 PAK me kualifikime si më poshtë:


**Për vitin akademik 2020-2021**

Stafi i departamenteve të FZHK	Departamenti i Kërkimit Shkencor		Departamenti i Kërkimit të Aplikuar		Qendra Kërkimore e Qëndrueshmërisë	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Profesor	4		-	-	-	-
Prof. Asoc	-	1	-	-	-	-
Doktor/Docent	3	1	3	3	3	-
Msc.	1	1	6	6	4	-
	<b>8</b>	<b>3</b>	<b>9</b>	<b>9</b>	<b>7</b>	<b>0</b>

Evidencë: Aneksi 40 – Tabelat përmbledhëse ASCAL.

1. Departamenti i Kërkimit Shkencor ka 7 PAE ku 6 prej tyre janë me grada/tituj akademik.
2. Departamenti i Kërkimit të Aplikuar ka 8 PAE, ku tre kanë gradën “Doktor”. Kjo është në përputhje me Ligjin 80/2015, neni 25, pika 4. “Departamenti ka në përbërje të tij të paktën shtatë anëtarë, të punësuar me kohë të plotë, si personel akademik, nga të cilët të paktën tre me grada shkencore ose tituj akademikë.



11  


3. Qendra e burimeve dhe Informacionit ka 7 PAE ku 2 prej tyre janë me gradën “Doktor” dhe një me titull akademik “Profesor i Asociuar”.

Evidencë: Aneksi 40 – Tabelat përmbledhëse ASCAL, Aneks 40.1, vizita në Institucion.

Në katër vitet e fundit stafi akademik në Departamentin që drejton programin e studimit ka qenë si më poshtë:

Stafi i Departamentit të Kërkimit të Aplikuar	Viti akademik 2017-2018		Viti akademik 2018-2019	
	PAE	PAK	PAE	PAK
Profesor			-	
Prof. Asoc			-	
Doktor/PhD	3		4	
Msc.	4	1	4	2
	<b>7</b>	<b>1</b>	<b>8</b>	<b>2</b>

Stafi i Departamentit të Kërkimit të Aplikuar	Viti akademik 2019-2020		Viti akademik 2020-2021	
	PAE	PAK	PAE	PAK
Profesor	-		-	
Prof. Asoc	-		-	
Doktor/PhD	5	1	3	3
Msc.	2	5	5	6
	<b>7</b>	<b>6</b>	<b>8</b>	<b>9</b>

\*) janë marrë vetëm katër vitet e fundit sepse më herët programi ka qenë pjesë e një fakulteti tjetër

Drejtuesi i Departamenti i Kërkimit të Aplikuar, që mbështet këtë program studimi ka gradën “Doktor”, pra në përputhje me Ligjin 80/2015, neni 45, pika 3.

Personeli akademik i aktivizuar për këtë program studimi zotëron minimumi diplomën “Master i Shkencave”, në përputhje me Ligjin 80/2015, neni 59, pika 6. Sipas viteve akademike.

Evidencë: Matrica EE

Evidence Udhezimi MASR

Evidencë: Aneksi 40, Tabela 7.

**Kriteri 6.** Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin profesional të studentëve, ku përfshihen dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që e

Në rregulloren e programit të studimit “Eficiencë Energjitike”, neni 1 jepet vetëm objektivi kryesor i këtij programi studimi që *synon të përgatisë teknikë të aftë për të kryer operacione praktikë në terren që lidhen me këte fushë e ku nevojat për këtë shërbim sa vinë e rriten.*

Në rregulloren e programit të studimit duhet të ishin vendosur objektiva të përcaktuara qartë për formimin profesional të studentëve.

karakterizojnë profilin profesional të programit.				
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	


<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

## II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMEVE TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL


### Standardi II.1

**Programet e studimeve me karakter profesional janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të këtij niveli dhe mundësitë e punësimit**



Kriteret	Vlerësimi
<b>Kriteri 1.</b> Programet e studimit me karakter profesional, përmbajnë dhe japin informacionet e nevojshme për objektivat formuese, rezultatet e pritshme të të nxënit, organizimin, strukturën, përmbajtjen, fushat e mundshme të punësimit apo të dhëna reale të punësimit të studentëve të diplomuar në këto programe.	<p>Mbështetur në vizitën në institucion dhe RVB, GVJ konstaton se të dhenat për programin (objektivat formuese, rezultatet e pritshme të të nxënit, organizimi, struktura, përmbajtja, fushat e mundshme të punësimit dhe të dhënat reale të punësimit të studentëve të diplomuar në këtë program) i bëhen të ditura studentëve që në fazat e para të njohjes me ofertën kurrikulare të Polisë. Studentët kanë mundësi të informohen nga:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Faqja e universitetit e cila përmban përmban objektivat formuese të të gjithë programeve profesionale, ndërsa në faqjen e dedikuar në këtë program studimi, të interesuarve u jepet informacion mbi profilin profesional dhe objektivat formuese të programit, përmbajtjen e përmbledhur të tij, si edhe mundësitë e punësimit.</li> <li>- Zyra e Pranimeve/ Marketingut të Universitetit POLIS, në aktivitetet promovuese të saj dhe në takimet që organizon me të interesuarit.</li> </ul> <p>Ndërsa nga fillimi i studimeve të tyre, studentëve u vihet në dispozicion</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- <i>Guida e Studentit</i> (Aneksi 10, Guida e Studentit),</li> <li>- Rregullorja Mësimore e Programit të Studimit (Aneksi 8, Rregullore Programit të Studimit). Në rregulloren e programit të studimi me karakter profesional në "Eficencë energjie" jepet informacion në lidhje me objektivin kryesor të programit të studimit, mundësitë për punësim, organizimin e studimeve, kërkesat për pranimin në programin e studimit, kriteret e pranimit, të drejtat dhe detyrimet e studentit, transferimi i studimeve në të njëjtin program studimi, diplomimi.</li> </ul>





13



	<p>Në rregulloren e programit të studimit, neni 1.2, jepen fushat e mundshme të punësimit në sektorë të ndryshëm si: sektori publik (bashki e komuna), sektori privat si biznese ndërtimi, kompani të instalimeve elektrike dhe HVAC, NGO shqiptare dhe të huaja që merren me zbatimin e projekteve në terren, etj.</p> <p><a href="http://www.universitetipolis.edu.al/?q=sq/node/33">http://www.universitetipolis.edu.al/?q=sq/node/33</a>,</p> <p><a href="http://www.universitetipolis.edu.al/sites/default/files/pdf/PROGRAMME%20STUDIMI/EE_al.pdf">http://www.universitetipolis.edu.al/sites/default/files/pdf/PROGRAMME%20STUDIMI/EE_al.pdf</a>,</p> <p>Evidencë Aneks 8: Rregullore e programit të studimit.</p> <p>GVJ konstaton se në syllabusin e secilës lëndë jepen rezultatet e pritshme të të nxënit. Evidencë Aneksi 11; Syllabuset EE.</p> <p>GVJ nuk gjeti të dhëna reale të punësimit për studentët që kanë mbaruar këtë program studimi nga materialet e vendosura nga Institucioni në sistemin AMS.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programet e studimit janë të organizuara në module/lëndë e aktivitete formuese, të vlerësuara me kredite, të ndara në vite e semestra e që janë në përputhje me përcaktimet vendëse e evropiane në fuqi.</p>	<p>Programi i studimit me karakter profesional “Eficiencë energjitike” është i organizuar në lëndë dhe aktivitete formuese, leksione, ushtrime, laboratore, të vlerësuara me kredite dhe të ndara në dy vite akademike, 4 semestra, me 120 kredite në total. Ai përmban 19 lëndë, ku janë të përfshira dhe praktikat profesionale si edhe projektin/punimi final.</p> <p>Kategoritë e veprimtarive formuese janë në përputhje me VKM 879, date 18.12.2019, “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM 41, datë 24.01.2018”, tabela 1.1:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Kategoria A – Lëndë Bazë <b>15%</b> (10 - 15%);</li> <li>- Kategoria B – Lëndë karakterizuese <b>52.5%</b> (45 – 55%);</li> <li>- Kategoria C – Lëndë ndërdisiplinore/integruese <b>12.5%</b> (5 – 15%);</li> <li>- Kategoria D – Lëndë plotësuese <b>15%</b> (10 – 15%);</li> <li>- Kategoria E – Detyrime përmbyllëse <b>5%</b> (3 – 5%),</li> </ul> <p>Evidencë: Matrica EE.</p> <p>Programi i studimit është i organizuar në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe përcaktimet evropiane në fuqi.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor, frekuentimin/ndjekjen e programit, vlerësimin e dijeve, aktivitete specifike etj.</p>	<p>GVJ nga shqyrtimi i RVB dhe DVV konstaton se programi i studimit me karakter profesional “Eficiencë Energjitike”, përmban planin mësimor për vitin akademik 2019-2020, planin mësimor të ndryshuar për vitin akademik 2020-2021, tabelën me ndryshimet e bëra.</p> <p>Plani mësimor 2020 – 2021 përfshin informacionin e nevojshëm në lidhje me ngarkesën mësimore në kredite sipas aktiviteteve mësimore si dhe orët në auditor, evidencë: Matrica EE.</p> <p>Matrica e planit mësimor përmban 19 lëndë, që zhvillohen në 2 vite akademike (kohëzgjatja normale), të ndarë në 4 semestra. Secila lëndë shoqërohet nga kreditet përkatëse, të cilat nisur nga natyra e lëndës dhe rëndësia e saj, janë të shpërndara sipas komponenteve (kredite leksioni, kredite seminari, kredite laborator, etj) dhe</p>

	<p>gjithashtu janë të përkthyer në orë mësimore në auditor dhe jashtë auditori për secilin komponent.</p> <p>Nga tabela e ndryshimeve gjykojmë se ato e kalojnë masën 20%.</p> <p>Për këtë në përputhje me VKM 41, datë 24.01.2018 “PËR ELEMENTET E PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË OFRUARA NGA INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË” duke qenë se ndryshimet janë më shumë se 20% duhej Vendimi i Senatit Akademik të Polis dhe miratimi nga MASR për këto ndryshime. GVJ nuk i gjeti këto informacione në Dosjen DVV.</p> <p>Për të bërë krahasimet e duhura do të ishte e nevojshme që Institucioni të kishte vënë në sistem dhe planin mësimor të vitit akademik, kur ky program studimi është akredituar për herë të parë, i cili mungon në DVV.</p> <p>Informacione në lidhje me frekuentimin/ndjekjen e programit, vlerësimin e dijeve, aktivitete specifike etj, jepen në Rregulloren Didaktike të Universitetit Polis, Kreu V, Organizimi i studimeve universitare. Evidencë: Aneksi 17.</p> <p>GVJ mendon që do të ishte mirë që në Rregulloren Didaktike të Universitetit POLIS të jepej tabela e ndarjes së krediteve në orë në auditor dhe individuale, në varësi të nivelit të programit të studimit dhe të veprimtarisë, për shembull 1 krediti leksion sa orë mësimore i takojnë në auditor dhe punë individuale, 1 kredit ushtrime sa orë mësimore i takojnë në auditor dhe punë individuale e kështu me radhë për laboratorët etj. Ky sugjerim nuk është vetëm për këtë program studimi por për të gjitha programet e studimit që ofrohen nga Universiteti Polis.</p> <p>Në planin mësimor dhe ngarkesën mësimore javore për secilën lëndë, rezultojnë 23 orë mësimore. Kjo është në përputhje me VKM 41, datë 24.01.2018 pika 2.1 d, ku kërkohet që ngarkesa mësimore javore të jetë deri në 25 orë mësimore. Evidencë: Matrica EE.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programet e studimit përmbajnë syllabuset e detajuara për secilën lëndë, për praktikën, ushtrimet apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët e aktivitetet formuese të programit të studimit.</p>	<p>Programi i studimit përmban syllabuset e detajuara për secilën lëndë.</p> <p>Syllabuset e lëndëve hartohen në përputhje me shtojcën 3, të VKM 879, date 18.12.2019, “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM 41, datë 24.01.2018”. Universiteti Polis e ka pasqyruar kër të në evidencën Aneksi 40, Tabela 14.</p> <p>GVJ nga shqyrtimi i evidencës Aneksi 11: Syllabuse EE konstaton:</p> <p>1. Syllabuset duhet të plotësohen me elementët e mëposhtëm, në përputhje me shtojcën 3 , të VKM 879:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Lloji i lëndës (e detyrueshme apo me zgjedhje)</li> <li>- Kodi i etikës;</li> <li>- Në çdo syllabus duhet të jepen të detajuara temat e mësimimit sipas leksioneve të çdo jave. Ka lëndë që nuk i japin temat mësimore sipas javëve ose disa të përmbledhura në module;</li> <li>- Disa syllabuse janë në gjuhën angleze kur gjuha e këtij programi studimi është gjuha shqipe psh: Kode dhe standarde Europiane dhe lokale në eficiencë energjitime, Teknologji arkitekture dhe ndërtimi, Retrofiti i ndërtesave, Cilësia e ambientit të brendshëm, Energjia e rinovueshme.</li> <li>- Duhet të jepet rregulli i Frekuentimit</li> </ul>





	<p>2. Syllabusi për lëndën Menaxhim biznesi mungon.</p> <p>3. Syllabusi i lëndës Auditim dhe çertifikim energjitik është 9 kredite ndërsa në planin mësimor 6 kredite.</p> <p>4. Lënda <i>Aplikime informatike</i> në planin mësimor ka emërtimin <i>Aplikime kompjuterike</i> në syllabus.</p> <p>5. Mungon në DVV, CV e pedagoges, e cila jep tre lëndë, të cilat janë shumë të ndryshme nga njëra tjetra dhe kërkojnë formime të ndryshme: <i>Aplikime informatike, Auditim dhe çertifikim energjitik, Energjia e rinovueshme.</i></p>								
<p><b>Kriteri 5.</b> Struktura dhe organizimi i programit të studimit është mjaftueshmërisht fleksibël për të mundësuar formimin e studentëve përgjatë programit dhe në përshtatje me punësimin.</p>	<p>Struktura dhe organizimi i programit të studimit me karakter profesional “Eficiencë Energjitike” është fleksibël për të mundësuar formimin e studentëve përgjatë programit dhe në përshtatje me punësimin.</p> <p>Programi i studimit është i organizuar në dy vite akademike, me 60 kredite secili vit. Në vitin e parë janë vendosur kryesisht lëndë të formimit bazë si: Fizikë e aplikuar, Aplikime informatike, Bazat e eficiencës energjitike, Autocad, Punë laboratorike 1 etj. Në vitin e dytë janë të vendosura lëndë praktike si: Retrofiti i ndërtesave, Auditim dhe çertifikim energjitik, Menaxhim biznesi, Mirëmbajtje, Punë laboratorike 2, Intership etj. GVJ i është referuar planit mësimor 2020-2021. Evidencë: Matrica EE.</p> <p>Gjatë vizitës në Institucion, në takimin e zhvilluar me studentët GVJ konstatoi se disa student të vitit të dytë të këtij programi studimi ishin të punësuar, ndërkohë që vazhdonin studimet. Evidencë: Vizita në Institucion.</p>								
<p><b>Kriteri 6.</b> Mësimi praktik dhe i elementeve të punës konkrete u është dhënë vendi dhe pesha e duhur në strukturë, vlerësim dhe rivlerësim.</p>	<p>GVJ konstaton se mësimi praktik dhe i elementeve të punës konkrete u është dhënë vendi dhe pesha e duhur në strukturën e programit të studimit, vlerësimin dhe rivlerësimin e tij.</p> <p>Nga plani mësimor vihet re se:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Lënda Punë laboratorike ka 12 kredite, të shpërndara 6 kredite në vitin e parë dhe 6 kredite në vitin e dytë.</li> <li>- Lënda Intership ka 6 kredite.</li> <li>- Të gjitha lëndët e vitit të dytë kanë kredite për laborator dhe detyrë/projekt.</li> <li>- Punimi final është një projekt praktik me 6 kredite,</li> </ul> <p>Evidencë: Matrica EE, minutat nga vizita në Institucion</p>								
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="510 1512 702 1601">Përmbushet</th> <th data-bbox="702 1512 949 1601">Përmbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="949 1512 1189 1601">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="1189 1512 1420 1601">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="510 1601 702 1653"></td> <td data-bbox="702 1601 949 1653"></td> <td data-bbox="949 1601 1189 1653" style="text-align: center;">X</td> <td data-bbox="1189 1601 1420 1653"></td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X	
Përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
		X							

<p><b>Standardi II.2</b>  <b>Struktura, plani mësimor dhe shpërndarja lëndore e programeve të studimit me karakter profesional, është në përputhje me objektivat formuese, rezultateve të të nxënit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve dhe kërkesave të tregut të punës për këto programe.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi</b></p>



<p><b>Kriteri 1.</b> Emërtimi, struktura dhe shpërndarja e në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore është në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.</p>	<p>GVJ kostaton se emërtimi i programit të studimit “Eficiencë Energjitike” është në përputhje me përcaktimin ligjor për programet profesionale në ligjin 80/2015. Shpërndarja në dy vite akademik dhe numri i krediteve 120 për këtë program studimi është në përputhje me ligjin 80/2015, neni 72, pika 1 për programet e studimit me karakter profesional.</p> <p>Vlerësimi në kredite dhe orë mësimore është në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Emërtimi, struktura dhe shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit, rezultateve të pritshme të të nxënit dhe punësimin e studentëve.</p>	<p>GVJ konstaton se emërtimi, struktura dhe shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore i programit të studimit me karakter profesional “Eficiencë energjitike”, mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit, rezultateve të pritshme të të nxënit dhe punësimin e studentëve.</p> <p>Kjo u konstatua dhe gjatë takimit me studentët. Evidencë: Minutat e takimit në institucion.</p> <p>Mbështetur në DVV dhe RVB, GVJ konstaton se kreditet janë të llogaritura sipas sistemit ECTS. Një krediti të formimit i korrespondon 25 orë mësimore punë të studentit, përbërë nga orë mësimore për transmetim dijesh në auditor (leksione, seminare, ushtrime, laboratore, etj.) dhe orë mësimore për përgatitje ose punë individuale të tij.</p> <p>Pesha e lëndëve në kredite varion nga 3-12 ECTS; disa kanë 3, 6, 9 apo 12 kredite, në varësi të ngarkesës dhe rëndësisë së tyre.</p> <p>Evidencë: Matrica EE</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Plani mësimor, natyra dhe emërtimi i moduleve/lëndëve, syllabuset e moduleve e të aktiviteteve formuese janë informuese dhe i përmbajnë të gjitha elementet e kërkuara.</p>	<p>Plani mësimor të studimit është i detajuar në kredite dhe orë mësimore, leksione, seminare, të ushtrimeve, laboratoreve dhe detyrës së kursit, mbështetur në Udhëzimin 29, datë 10.09.2018, Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë, pika 4. Evidencë: Matrica EE.</p> <p>Syllabuset e lëndëve duhet të plotësohen me disa elementë për të qenë në përputhje të plotë me shtojcën 3 të VKM 879.</p> <p>Syllabuset e programit të studimit janë informuese në lidhje me aktivitetet kryesore të tyre, leksione, ushtrime, laboratore, detyre, evidencës Aneksi 11: Syllabuse EE.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Ka një raport të balancuar midis moduleve/aktiviteteve të formimit teorik përkundëjt atyre praktike (50:50). Rreth 25% e programit i dedikohet aftësimin në praktikë/punë konkrete në profesion.</p>	<p>Nga shqyrtimi planit mësimor 2020-2021, GVJ konstaton se raporti midis moduleve/aktiviteteve të formimit teorik përkundëjt atyre praktike është: <b>513</b> ore leksione/<b>543</b> ore seminar, ushtrime, laboratore, detyra, praktike ose <b>48.6</b> % formim teorik kundëjt <b>51.5</b> % formim praktik.</p> <p>Evidence 40, Tabelat përmbledhëse ASCAL, tabela 13.</p> <p>GVJ konstaton se nëpërmjet lëndëve Punë laborator 1 dhe 2, Intership, Projekti final gjithsej 24 kredite si dhe krediteve të detyrave rreth 6 kredite më shumë, pra 30 kredite në total, se 25 % e programit dedikohet aftësimin në praktikë/punë konkrete në profesion. Evidencë: Matrica EE.</p>




<p><b>Kriteri 5.</b> Klasifikimi sipas aktiviteteve formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues dhe orientimin e studentit drejt studimeve të mëtejshme dhe/ose në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Klasifikimi sipas aktiviteteve formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p> <p>Mbështetur në planin mësimor të këtij programi studimi GVJ gjykon se studenti mund të transferohet në një program të njëjtit cikël, por jo drejt studimeve të mëtejshme të ciklit Bachelor.</p> <p>Evidencë vizita në Institucion.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>


<p><b>Standardi II.3</b>  <b>Përmbajtja e lëndëve, moduleve dhe formave të tjera formuese të programeve të studimit me karakter profesional është në përputhje me objektivat formuese, rezultatet e të nxënës dhe kërkesat e tregut të punës për këto programe</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit përmban të dhëna të plota mbi përmbajtjen e moduleve/lëndëve të formimit teorik e praktik dhe aktiviteteve të tjera të formimit sipas strukturës e planit të studimit.</p>	<p>GVJ konstaton se programi i studimit me karakter profesional “Eficiencë Energjitime” përmban të dhëna të plota mbi përmbajtjen e lëndëve të formimit teorik e praktik dhe aktiviteteve të tjera të formimit sipas strukturës e planit të studimit.</p> <p>Në planin mësimor jepen të ndara veç kreditet e leksioneve, seminareve, laboratorët, detyrës së kursit, siç janë dhënë dhe në syllabuset përkatëse. Evidencë: Matrica EE; Aneksi 11: Syllabuse EE.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Përmbajtja e programit të studimit është aktuale, i plotëson kërkesat e veçanta të profesionit dhe kërkesat për aftësitë shprehite e kërkuara/të pritshme nga punëdhënësit.</p>	<p>GVJ konstaton se përmbajtja e programit të studimit është aktuale në përputhje me objektivin e këtij programi profesional, që synon të përgatisë studentët në formimin e një aftësie kritike në një fushë të rëndësishme si ajo e përdorimit të energjisë me leverdi ekonomike në banesa;</p> <p>Lëndët e vendosura në planin mësimor si: Smart home, Sistemet HVAC, Retrofiti në ndërtesa, Teknologji arkitekturore dhe ndërtimi etj, plotësojnë kërkesat e veçanta të profesionit dhe kërkesat për aftësitë shprehite e kërkuara/të pritshme nga punëdhënësit. Evidencë: Matrica EE.</p> <p>Gjatë vizitës në Institucion studentët sugjeruan se lënda e <i>gjuhës angleze</i> dhe lënda e <i>eficiencës së energjisë së sistemeve elektrike në banesa</i> do të ishin dy lëndë që do të ndihmonin më shumë në kërkesat e pritshme nga punëdhënësi, duke patur parasysh kërkesat e tregut të punës për këtë profesion, Evidencë: Vizita në Institucion.</p> <p>Materialet mësimore për lëndët e profesionit janë të përgatitur nga pedagogët e lëndës përkatëse, reference syllabuset, evidence - Aneksi 11: Syllabuse EE.</p> <p>Gjithashtu literatura e dhënë në lëndët profesionale nuk është e pesë viteve të fundit, evidence - Aneksi 11: Syllabuse EE.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Përmbajtja parashikon zhvillimin e aftësive të transferueshme, e shtrirë edhe në</p>	<p>Programi i studimit me karakter profesional “Eficiencë Energjitime”, është i shtrirë ( sipas VKM 879, datë 18.12.2019, tabela 1.1):</p>

<p>modulet e përbajtjen e tyre, gjatë zhvillimit të kurrikulës dhe në metodat e mësimdhënies dhe vlerësimit.</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- në lëndët bazë, me 18 kredite, me 15% (10-15%)</li> <li>- Lëndët karakterizuese 63 kredite me 52.5% (45-55%)</li> <li>- Lëndët ndërdisiplinore me 15 kredite, 12.5% (5-15%)</li> <li>- Lëndët plotësuese me 18 kredite, 15%, (10-15%)</li> <li>- Detyrimi përmbyllës 6 kredite, 5 % (3-5%)</li> </ul> <p>Metodat kryesore të mësimdhënies janë leksione, seminare, ushtrime, laboratore, detyre kursi. Vlerësimi i lëndëve bëhet në mënyrë të vazhdueshme, ku: frekuentimi ka 10% dhe pjesmarrja aktive gjatë zhvillimit të lëndës dhe detyra ka 10%, testimi në mes të semestrit i njohurive të marra 20 % dhe testimi përfundimtar 60 %, evidence - Aneksi 11: Syllabuse EE; Aneksi 17: rregullore didaktike.</p>								
<p><b>Kriteri 4.</b> Modulet dhe aktivitetet e formimit teorik e praktik/punë konkrete mundësojnë përfitim e njohurive, aftësive dhe shkathtësive ndërkurrikulare, të menduarit kritik, zgjidhjen e problemeve në kontekste konkrete, komunikimin dhe marrëdhëniet me të tjerë, si dhe orientimin cilësor në përvojën e punës.</p>	<p>GVJ konstaton se aktivitetet e formimit teorik dhe praktik të lëndëve të ndryshme mundësojnë përfitim e njohurive, aftësive dhe shkathtësive ndërkurrikulare. Lëndët si Praktikë laboratorike, Mirëmbajtje, Menaxhim biznesi, Intership ndihmojnë studentët në të menduarit konkret, komunikimin dhe marrëdhëniet me të tjerë, si dhe orientimin cilësor në përvojën e punës, evidence - Aneksi 11: Syllabuse EE.</p> <p>Bazuar në takimet me stafin dhe studentët, GVJ mësoi se vend të rëndësishëm në kurrikul zë gjithashtu zhvillimi i të menduarit kritik, duke aplikuar shumë pjesën e projekteve konkrete. Në këtë program studimi dhe provimi përfundimtar është me një projekt konkret. Kjo i ndihmon ato në zgjidhjen e problemeve në kontekste konkrete.</p>								
<p><b>Kriteri 5.</b> Bashkëpunimi me punëdhënësit, internship-i/përvoja praktike, tutorazhi, e vlerësimi i tyre në profesion është e mjaftueshme, e përshtatshme dhe garanton formimin praktik në përputhje me kërkesat e profesionit.</p>	<p>Institucioni ka bashkëpunim me kompani të ndryshme për realizimin e intershipit, evidence - Aneksi 7, lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit.</p> <p>Realizimi i pjesës praktike me anë të lëndëve Punë Laboratori, Mirëmbajtje dhe Intership është e mjaftueshme, e përshtatshme dhe garanton formimin praktik në përputhje me kërkesat e profesionit.</p>								
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<table border="1" style="width: 100%; text-align: center;"> <thead> <tr> <th style="width: 25%;"></th> <th style="width: 25%;">Përmbushet pjesërisht</th> <th style="width: 25%;">Përmbushet kryesisht</th> <th style="width: 25%;">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II</b></p>		<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X




19




### III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

<b>Standardi III.1</b>	
<b>Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional përmes politikave e udhëzimeve të posaçme dhe mbështetet në metodat dhe praktikat më të mira të fushës</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton udhëzues të posaçëm, ngre struktura të posaçme dhe zhvillon mekanizma të vlerësimit e të monitorimit të cilësisë së mësimdhënies dhe metodave të përdorura dhe aftësive të stafit të angazhuar, duke përfshirë aktivisht studentët në këtë proces. Rezultatet e këtyre vlerësimeve bëhen publike.</p>	<p>GVJ konstaton se Institucioni Polis ka ngritur njësinë e sigurimit të brendshëm të cilësisë, NJSBC për vlerësimin dhe monitorimin e cilësisë së mësimdhënies, e përbërë nga 9 anëtarë ku: 5 anëtarë janë staf akademik pa kompetenca ekzekutive, që i përkasin të tre fakulteteve përkatëse, një përfaqësues nga sekretaria mësimore, një përfaqësues i studentëve, një përfaqësues nga komuniteti i biznesit, dhe një përfaqësues Alumni. Evidencë: Aneksi 35 – Rregullore e NJSBC.</p> <p>NJSBC ka detyra kryesore:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Aprovimi, monitorimi dhe shqyrtimi periodik i programeve;</li> <li>- Vlerësimi i studentëve;</li> <li>- Sigurimi i cilësisë së stafit mësimdhënës;</li> <li>- Burimet e mësim nxënies dhe mbështetjes së studentëve;</li> <li>- vlerësimin e aktivitetit kërkimor-shkencor individual dhe institucional;</li> <li>- vlerësimin e financimit dhe burimeve njerëzore në funksion të procesve kryesore të mësimdhënies dhe kërkimit,</li> <li>- bashkëpunimin me institucione homologe brenda dhe jashtë vendit;</li> <li>- vlerësimin e hapjes dhe marrëdhënieve të institucionit me tregun e punës, lokal, kombëtar, rajonal e më gjerë</li> <li>- Informimi i publikut.</li> </ul> <p>Vlerësimi i procesit mësimor bazohet në tre përberës: vlerësimi nga studentët; vlerësimi nga kolegët; vetëvlerësimi.</p> <p>Procesi i vlerësimit të cilësisë së mësimdhënies të stafit akademik përbëhet nga 4 komponentë vlerësimi: nga studentët, kolegët, vetëvlerësimi (vetvetja) dhe nga eprori/ët. Evidencë: Aneksi 16; 16.1; 16.2; 16.3.</p> <p>Njësia bazë që mbështet programin e studimit përgatit raport në lidhje me zhvillimin e procesit mësimore, cilësinë e studentëve dhe rezultatet e arritura në provime për çdo lëndë.</p> <p>Njësia e sigurimit të brendshëm të cilësisë harton raporte vjetore por GVJ nuk e gjeti atë të bërë publik në faqen zyrtare të Institucionit. Evidencë: Aneksi 15; <a href="http://www.universitetipolis.edu.al/?q=sq/node/1627">http://www.universitetipolis.edu.al/?q=sq/node/1627</a></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, laboratorët, detyra e kursit/eseja,</p>	<p>Format kryesore të mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, laboratorët, detyra e kursit, praktikat profesionale mbështetur në dokumentacionin e vënë në sistem dhe nga takimet e realizuar me stafin dhe studentët gjatë vizitës në institucion.</p>

<p>praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni e që është e përshtatshme për realizimin e programit të studimit.</p>	<p>Gjatë semestrit të dytë të vitit akademik 2020-2021 janë zhvilluar dhe leksionet dhe ushtrimet online duke shfrytëzuar platformat online, ndërsa laboratorët janë zhvilluar në auditor. Evidencë: Vizita në Institucion.</p> <p>Platformat që u përdoren ishin të shumta, si Zoom, Google classroom, Google meet, etj. Edhe pse në kushte të vështira emergjence dhe të eksperimentuara për herë të parë, nga vlerësimet e studentëve online, për mbarëvajtjen e procesit mësimor dhe performancën e pedagogëve, rezultojnë se studentët kanë mbetur mjaft të kënaqur nga kjo eksperiencë e re dhe se stafi akademik është përshtatur që në ditët e para të izolimit me mësimin online. Evidencë: Aneksi 15-Raporti I vlerësimit të NJSBC 2019-2020.</p> <p>Të gjitha këto forma janë të përshtatshme për të realizuar këtë program studimi me karakter profesional, në kushtet e pandemisë.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Personeli akademik përdor forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti, në përgjigje dhe të diversitetit dhe nevojave të studentëve.</p>	<p>GVJ konstaton se personeli akademik i këtij programi studimi përdor forma dhe mënyrat tradicionale të mësimdhënies nëpërmjet shpjegimit në tabelë, shpjegimit me powerpoint.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion nga biseda me pedagogët dhe studentët GVJ i tregua se një metodë efektive e mësimdhënies ishte ajo interaktive pedagog-student, që përdorej më shumë gjatë orëve të ushtrimeve apo të laboratoreve, si dhe detyrave të ndryshme. Evidencë: Vizita në Institucion.</p> <p>Në Kreun V, Neni 20 të Rregullores Didaktike janë të përcaktuara format e mësimimit që parashikohen e përdoren në Universitetin POLIS. Këto janë si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Format e mësimimit teorik e praktik: leksionet, seminarët, ushtrimet, punët laboratorike dhe studio, konsultimet, prezantimet, praktikat profesionale, detyrat e kursit, projektet e kursit, ese, punime e kërkime shkencore eksperimentale në fushat përkatëse etj;</li> <li>- Format e kontrollit të dijeve: provimet e kursit me shkrim ose me gojë ose në formën e bashkëbisedimeve të hapura, mbrojtje e detyrave e projekteve të kursit, mbrojtje e praktikave profesionale, provimet, mbrojtje e temave e diplomave, etj. Evidencë: Aneksi 17, Rregullore Didaktike</li> </ul> <p>Në raste të disa lëndëve specifike si psh “Bazat e Efiçencës”, është e kombinuar me metoda të ndryshme mësimdhënie, ku përpos pjesës teorike në auditor një vend të rëndësishëm zë komponenti i praktikës laboratorike; kjo e fundit zhvillohet në laborator ku studentët angazhohen në montimin e sistemeve HVAC, sistemeve të tjera të pjesë e laboratorit dhe të tjera veprimtari aplikative praktike. Evidencë: Aneksi 18, Syllabus Bazat e Efiçencës</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies, përfshirë ato</p>	<p>Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie si ai PAE dhe PAK ka kualifikimin e nevojshëm mbështetur në legjislacionin në fuqi, minimum i kualifikimit është Master i Shkencave. në përputhje me Ligjin 80/2015, neni 59, pika 6. Sipas viteve akademike:</p> <p>Në vitet që nga akreditimi paraardhës rezultojnë këto të dhëna:</p>



21



interaktive e gjithëpërfshirëse, sipas tematikave dhe profilit.

Stafi i Programit të studimit	Viti akademik 2020-2021		Viti akademik 2019-2020		Viti akademik 2018-2019	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Profesor	-	-	-	-		
Prof. Asoc	-	-	-	-		
Doktor/Docent	2	2	2	1	3	
MND	1	-	1	-		
Msc.	3	2	2	2	4	2
	<b>6</b>	<b>4</b>	<b>5</b>	<b>3</b>	<b>7</b>	<b>2</b>

Stafi i Programit të studimit	Viti akademik 2017-2018		Viti akademik 2016-2017		Viti akademik 2015-2016	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Profesor						
Prof. Asoc						
Doktor/Docent	4		3		1	
MND	1		1			
Msc.	6	1	5		10	1
	<b>11</b>	<b>1</b>	<b>9</b>	<b>0</b>	<b>11</b>	<b>1</b>

Evidence: Tabela përmbledhëse, sjellë pas vizitës në Institucion.

Shpërndarja e ngarkesës së personelit akademik për programin e studimit me karakter profesional, referuar planit mësimor 2020-2022, duke marrë në llogaritje dhe intershipin është: 718 orë PAE dhe 525 orë PAK ose 58% PAE dhe 42% PAK.

Kushti ligjor që PAE të mbajë 70% të ngarkesës nuk plotësohet,

Personeli akademik i angazhuar është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdorin metoda të ndryshme të mësimdhënies, përfshirë ato interaktive e gjithëpërfshirëse, sipas tematikave dhe profilit. Mbështetur në CV e vendosura në sistem, janë specialist të fushave përkatëse, por mbajtja e më shumë së 50% të ngarkesës mësimore për këtë program studimi nga PAK, krijon pasiguri për këtë program studimi.

Evidence: Matrica EE.

**Kriteri 5.** Institucioni duhet të mbështesë stafin përmes njohjes me shembujt e praktikave të mira, të nxisë dhe të inkurajojë personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së mësimdhënies.

GVJ konstaton se Institucioni nëpërmjet rezultateve të nxjerra nga raportet e vlerësimit të NJSBC, vlerësimit nga stafi dhe studentët mbështesë stafin përmes njohjes me shembujt e praktikave të mira, të nxisë dhe të inkurajojë personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së mësimdhënies.

Evidence: Aneksi 32 –Strategjia e menaxhimit të burimeve njerëzore.



**Shkalla e përmbushjes së standardit**

Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X	

**Standardi III.2**

**Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional, duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike të nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor**

Kriteret	Vlerësimi
<p><b>Kriteri 1.</b> Procesi mësimor teorik e praktik, realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor.</p>	<p>GVJ konstatoi, gjatë vizitës në Institucion, se ai ka hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor për këtë program studimi.</p> <p>Të gjithë laboratorët dhe punët praktike për këtë program studimi kryheshin pranë Laboratorit të Eficiencës Energjetike. Evidencë: Vizita në Institucion; Aneks 20 Planimetria dhe kapacitetet infrastrukturore</p> <p>Krahas ambjenteve të përbashkëta si auditorët, biblioteka, etj, ky program disponon edhe laboratorin e dedikuar, për programin. Ai është i pajisur me kompjuter ku është instaluar programi i MC4 software mjaft i rëndësishëm për programin e Eficiencës Energjetike, bazën materiale për servisimin e sistemeve HVAC. Paisjet monitoruese të sistemeve si Anemometrat, Termokamerat, voltmetrat etj. Në këto mjedise zhvillohen pjesë e komponentë të rëndësishëm të procesit mësimor, Evidencë: Aneks 21: Lista e pajisjeve të laboratorit.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesin mësimor, si dhe sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirë vetjake të dedikuar.</p>	<p>Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike veçanërisht ato të profilit sisteme kompjuterike. Institucioni ka sallë kompjuterash ne katin zero dhe në katin e parë. Në katin e parë ka gjithashtu dhe një sallë interneti.</p> <p>Evidencë: Tabelat përmbledhëse .</p> <p>Institucioni Polis ka sistem për komunikim të brendshëm elektronik dhe hapësirë vetjake të dedikuar nëpërmjet portalit të Polis, Pitagora:</p> <p><a href="https://polis.pitagora.rash.al/login">https://polis.pitagora.rash.al/login</a></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>Nga RVB dhe takimet me stafin akademik GVJ konstatojnë se:</p> <p>Leksionet/materialet e studimit, organizohen nga pedagogu në formën e një dispense dhe dorëzohen në bibliotekë përpara fillimit të vitit akademik, si dhe i vihen në dispozicion studentëve edhe në formë elektronike. Literatura e detyrueshme për secilën lëndë të planit mësimor ofrohet në gjuhën shqipe, ajo ndodhet fizikisht e sistemuar në hapësirën e bibliotekës nga ku mund të aksesohet nga secili student sipas nevojës Evidencë: Aneks 31, Broshura e bibliotekës.</p> <p>Nga vizita e bibliotekës së Institucionit GVJ konstatoi se literatura bazë dhe ndihmëse për këtë program studimi me karakter profesional ishte e kufizuar.</p> <p>Kjo duket qartë dhe në syllabuset e lëndëve të këtij programi studimi ku shumica e materialeve mësimore është e përgatitur nga pedagogët e lëndës.</p> <p>Evidencë Syllabuset EE.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët</p>	<p>Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me</p>





aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.	programin e studimit. Institucioni ka realizuar regjistrim në dy biblioteka online EBSCO dhe Jstore. Evidencë: RVB Evidencë: Vizita në Institucion.								
<b>Kriteri 5.</b> Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.	Laboratori i eficiencës së energjisë ku kryheshin punët laboratorike dhe praktike për këtë program studimi ishte i mjaftueshëm dhe i pajisur siç duhet. Kjo për shkak të numrit të vogël të studentëve që ka ky program studimi. Aneksi 28: Numri i studenteve të regjistruar  Ky laborator shfrytëzohet shumë mirë dhe në mënyrë të vazhdueshme, për shkak se të gjitha lëndët i kryenin laboratorët në të. Sipas RVB konstatohet që: gjatë periudhës së verës 2020, në mënyrë që të rikuperoheshin orët praktike të pamundura të realizoheshin në kushtet e pandemisë, laboratori u vu në dispozicion të stafit dhe studentëve sipas një grafiku të mirëpërcaktuar në mënyrë që të realizohej praktika e çdo lënde të zhvilluar online, gjatë semestrit të dytë të vitit akademik 2019-2020. Evidencë Vizita në institucion. Aneks 22, Kalendari i Praktikave, për semestrin e dytë 2019-2020)								
<b>Kriteri 6.</b> Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (elearning) dhe mbështet e nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.	GVJ gjatë vizitës në Institucion në takimin e zhvilluar me personalin akademik konstatoi se janë përdorur platformat online si Zoom, Google classroom, Google meet, etj. Në funksion të mësimdhënies, leksione dhe seminare, gjatë vitit akademik 2020 – 2021, janë zhvilluar online, si pasojë e situatës së pandemisë.  Evidencë Vizita në institucion.								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përbushet</th> <th>Përbushet pjesërisht</th> <th>Përbushet kryesisht</th> <th>Përbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht				X
Përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht						
			X						

### Standardi III.3

**Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat garantojnë cilësinë e mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit dhe rritjen e vetëdijes për përmirësimin e tyre**

Kriteret	Vlerësimi
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni organizon struktura/njësi në nivel institucional që ndjekin, vlerësojnë dhe monitorojnë procesin e mësimdhënies dhe koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së saj.	Struktura kryesore e institucionit, në nivel institucional, që ndjek, monitoron dhe vlerëson procesin e mësimdhënies është NJSBC.  Njësisë e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë e shtrin fushën e veprimit të saj në, evidencë Rregullore e NJSBC, neni 5:  a. analizën në përmbajtje të programeve të studimit, pas marrjes së feedbackut nga studentët, pedagogët, studentët e punësuar dhe tregu i punës;  d. vlerësimin shumëdimensional të stafit mësimdhënës e mbështetës mbi bazën e treguesve të qartë, specifike e të njohur;  NJSBC vlerëson dhe monitoron procesin e mësimdhënies dhe koordinon dhe bashkërendon punën me njësitë kryesore/bazë në kuadër të përmirësimit të cilësisë së saj.






	<p>Evidencë Rregullore e NJSBC, neni 6 - Procesi i vlerësimit të procesit mësimor.</p> <p>Gjatë vizitës në Institucion, në takimin e zhvilluar me NJSBC na u sqarua se kjo njësi në mënyrë periodike ushtron kontrollon lidhje me mësimdhënien, prezencën e studentëve në mësim, cilësinë e mësimdhënies, cilësinë e syllabuseve dhe zbatimin e standarteve sipas kornizës ligjore në fuqi.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë është përgjegjëse për procesin e mësimdhënies, cilësinë e saj dhe rritjen e vetëdijes te personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.</p>	<p>Njësia kryesore FKZH dhe njësia bazë DKA janë përgjegjëse për procesin e mësimdhënies, cilësinë e saj dhe rritjen e vetëdijes te personeli akademik dhe studentët për cilësinë e programit të studimit me karakter profesional “Eficiencë Energjitime”.</p> <p>Për monitorim e mësimdhënies në departamentin që mbështet këtë program studimi shërben Dekani i FKZH, drejtuesi i njësies bazë, koordinatori i programit të studimit dhe sekretaria mësimore.</p> <p>Evidence Vizita në Institucion, Aneksi 43.</p> <p>Nëpërmjet analizës vjetore të ecurisë së procesit mësimor dalin problematikat që kanë shoqëruar procesin mësimor në këtë program studimi.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimeve dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja, në përputhje me natyrën dhe specifikën e programeve profesionale.</p>	<p>GVJ konstaton se për këtë program studimi personeli akademik me kohë të plotë, ai PAK dhe personeli ndihmësakademik janë të angazhuar dhe kanë përgjegjësinë kryesore për një mësimdhënie cilësore.</p> <p>Nëpërmjet angazhimit të studentëve në punë laboratoriale, detyra, mësimet të hapura, etj., realizohet zbatimi i metodave të reja, në përputhje me natyrën dhe specifikën e programit profesional.</p> <p>Evidence Vizita në Institucion, Aneksi 29, Leksion i hapur.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies përmes trajnimeve të vazhdueshme të personelit akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të tyre.</p>	<p>Strukturat përgjegjëse në Universitetin Polis mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies përmes trajnimeve të vazhdueshme të personelit akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të tyre.</p> <p>Një eksperiencë shumë e mirë është pjesëmarrja në projektin <i>Erasmus + CBHE Program</i>:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Strategic support on strengthening the quality assurance structures at the private higher education institutions in Albania/ QainAL.</li> <li>2. Developing Research and Innovation Capacities in Albania and Kosovo/ DRIVE;</li> </ol> <p>Evidencë <a href="http://www.universitetipolis.edu.al/?q=sq/node/23">http://www.universitetipolis.edu.al/?q=sq/node/23</a></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për</p>	<p>GVJ gjatë vizitës në Institucion konstatoi se personeli akademik u adoptua shpejt me metodat e reja të mësimdhënies online gjatë këtij viti akademik 2020-2021, kjo e dhënë u deklarua nga drejtuesi i departamentit dhe pedagogët gjatë takimit të realizuar me to në institucion.</p>

rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.	Personeli akademik i punësuar në këtë program studimi, vepron në një përputhje me rregulloren e përgjithshme të Universitetit Polis.  Evidencë Aneksi 5 Rregullore e përgjithshme.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

**Standardi III.4**  
**Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme për vlerësimin e njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën për çdo student.**

Kriteret	Vlerësimi												
<p><b>Kriteri 1.</b> Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në rregullore të posaçme, të cilat bëhen publike. Institucioni mban dhe ruan dokumentacionin e vlerësimeve, ankimimet dhe rishqyrtimet e vlerësimit, sipas afateve e procedurave në rregulloret përkatëse.</p>	<p>GVJ gjatë vizitës në Institucion konstatoi nga personeli akademik dhe studentët se mënyrën e vlerësimit të studentëve në programin e studimit EE mundësohet nëpërmjet materialeve të printuara dhe të përgatitura posaçërisht për studentët si POLIS @ a Glance, Guida e Studentit, etj.</p> <p>Informacionet lidhur me rregulloren e studimit, rregullat e brendshme në Universitet, kriteret e kalueshmërisë etj., publikohen në faqen e fakultetit dhe në materialet e mësipërme.</p> <p>Evidencë Aneks 17. Rregullore Didaktike.pdf; Aneks 18. Syllabus Bazat e Efiçencës.pdf</p>												
<p><b>Kriteri 2.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>GVJ konstaton se vlerësimi i studentit në Universitetin POLIS respekton parimin e vlerësimit bazuar në disa komponentë duke iu larguar konceptit tradicional të një provimi të vetëm në fund të lëndës, në përputhje kjo dhe me kriteret shtetërore në fuqi dhe me frymën e procesit të Bolonjës. Lëndët e formimit bazë dhe ato teorike i caktojnë një peshë më të lartë provimit ose testeve teorike, ndërkohë në lëndët karakterizuese ose laboratorët, projekteve dhe detyrave peshë e secilit komponent vlerësimi jepet në programet e secilës lëndë.</p> <table border="1" data-bbox="627 1319 1337 1594"> <thead> <tr> <th>Format e kontrollit të njohurive</th> <th>Pjesa (në %) ndaj totalit</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Ndjekja e lëndës dhe pjesëmarrja aktive</td> <td>10%</td> </tr> <tr> <td>Plotësimi i detyrimeve (laboratorike, detyrave të kursit, praktikave profesionale, etj)</td> <td>0 – 90%</td> </tr> <tr> <td>Diskutime në klasë</td> <td>0 – 40%</td> </tr> <tr> <td>Provimi përfundimtar</td> <td>0 – 90%</td> </tr> <tr> <td>Në total</td> <td>100%</td> </tr> </tbody> </table> <p>Mënyra e vlerësimit parashtrohet në syllabusin e çdo lënde dhe u komunikohet studentëve që në orën e parë të zhvillimit të lëndës, nga titullari i kësaj të fundit evidencë Aneksi 11, Format Syllabusi.pdf</p> <p>Në përfundim të lëndës, mbështetur në komponentët e përcaktuar në syllabus, realizohet shpallja e rezultateve në sistemin online, në faqen individuale të studentit. Një mënyrë e tillë afishimi e rezultateve, ruan anonimatën e studentëve dhe parandalon forma të ndryshme abuzimi, duke garantuar transparencë maksimale të procesit.</p>	Format e kontrollit të njohurive	Pjesa (në %) ndaj totalit	Ndjekja e lëndës dhe pjesëmarrja aktive	10%	Plotësimi i detyrimeve (laboratorike, detyrave të kursit, praktikave profesionale, etj)	0 – 90%	Diskutime në klasë	0 – 40%	Provimi përfundimtar	0 – 90%	Në total	100%
Format e kontrollit të njohurive	Pjesa (në %) ndaj totalit												
Ndjekja e lëndës dhe pjesëmarrja aktive	10%												
Plotësimi i detyrimeve (laboratorike, detyrave të kursit, praktikave profesionale, etj)	0 – 90%												
Diskutime në klasë	0 – 40%												
Provimi përfundimtar	0 – 90%												
Në total	100%												

Adresa: "Rruga e Durrësit" Nr. 219 Tiranë


E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)

Tel:+355 [04] 222-43423


Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

26

<p><b>Kriteri 3.</b> Në fillim të çdo lënde/moduli, studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/ moduleve nga titullari i lëndës /modulit.</p>	<p>Gjatë vizitës së GVJ me studentët u evidentua se studentët informohen në fillim të çdo lënde apo moduli mbi metodologjinë e vlerësimit të njohurive, përmes prezantimit të syllabusit, në të cilin është e pasqyruar dhe skema e tabela e vlerësimit me të gjithë komponentët e saj.</p> <p>Evidencë Aneksi 11, Format Syllabusi.pdf; evidencë Aneksi 11, Format Syllabusi.pdf</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik, duke venë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat garantojnë anonimat, eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>Për programin profesional në Eficencë Energjitike, format e kontrollit të dijeve janë: provimet e kursit me shkrim ose me gojë ose në formën e bashkëbisedimeve të hapura, mbrojtje e detyrave e projekteve të kursit, mbrojtje e praktikave profesionale, provimet, etj.</p> <p>Evidencë Aneks 17. Rregullore Didaktike.pdf</p> <p>Në përfundim të lëndës, mbështetur në komponentët e përcaktuar në syllabus, realizohet shpallja e rezultateve në sistemin online, në faqen individuale të studentit. Një mënyrë e tillë afishimi e rezultateve, ruan anonimat në studentëve dhe parandalon forma të ndryshme abuzimi, duke garantuar transparencë maksimale të procesit.</p> <p>Aneks 16.3 Prezantim_menyrja e vleresimit.pdf</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisione provimi, shoqërohet me komente e këshilla mbi procesin e të nxëniet për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Në lëndët profesionale të programit EE, nisur nga vetë natyra aplikative e këtyre lëndëve, të cilat janë pjesë e planit mësimor, të vlerësuara me kreditet respektive, vlerësimi i studentëve realizohet përmes provimit me gojë, ku ata paraqesin një raport të asaj çka kanë realizuar dhe mësuar praktikisht gjatë periudhës së zhvillimit të lëndës, ku konsiderohet si element vlerësimi edhe angazhimi dhe performanca e vazhdueshme e tyre.</p> <p>Në përfundim të procesit të vlerësimit, studentëve iu komunikohen në mënyrë individuale, pikat e tyre të forta në atë lëndë, si edhe vihen në pah pikat e tyre të dobëta, duke iu dhënë sugjerimet përkatëse për t'i ndihmuar për përmirësim të mëtejshëm të tyre.</p> <p>Evidencë Aneks 12. Praktike_Laboratorike.pdf</p>			
<p><b>Kriteri 6.</b> Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse, duke garantuar njëkohësisht të drejtat e studentëve, për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me këto rregullore.</p>	<p>Mbështetur në komponentët e përcaktuar në syllabus, në përfundim të lëndës realizohet shpallja e rezultateve në sistemin online ESSE 3. Kjo i jep mundësi studentëve të shohin vlerësimin për çdo komponent. Sinkron me të drejtat e studentëve të programit Eficencë Energjitike, të përcaktuara në Rregulloret e Programit, studenti ka të drejtën e ankimit për notën, dhe procedura përkatëse.</p> <p>Evidencë Aneks 17. Rregullore Didaktike.pdf</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>




27




**Standardi III.5**

**Zhvillimi i programit të studimit, deri në diplomim, garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët duke dhënë njëkohësisht njohuri të aplikuara dhe kompetenca profesionale lehtësisht të përdorshme në tregun e punës, apo për studime të mëtejshme.**


Kriteret	Vlerësimi
<p><b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë përfundimin e njohurive, zhvillimin e aftësive profesionale dhe të veçanta të studentëve, që janë në përputhje me rezultatet e pritura të të nxënësve për programet me karakter profesional.</p>	<p>Gjatë vizitës së GVJ me studentët ata u shprehën se baza laboratorike, mënyra e shpjegimeve praktike nga pedagogët, përfshirja në aktivitete të ndryshme praktike dhe organizimi i praktikave profesionale, i ka dhënë atyre mundësi dhe baza të forta të implementimit teoriko-praktik të dijeve të fituara në zgjidhje e problematikave në fusha si:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Zbatimi i sistemeve të HVAC;</li> <li>• Optimizimi i përdorimit të sistemeve HVAC sipas tipit të ndërtesës;</li> <li>• Rekomandimi i masave të ndryshme të përmirësimit të performancës energjitike të ndërtesave;</li> <li>• Zbatimi i masave të ndryshme të kursimit të energjisë në banesa dhe objekte komerciale;</li> <li>• Pjesëmarrja në procesin e auditit energjitik dhe çertifikimit energjitik të banesave;</li> </ul> <p>(Evidence Aneks 14. Kalendar i Praktikave.pdf)</p> <p>Përfshirja e studentëve të Programi Profesional në Eficiencë Energjitike në bashkëpunim me partnerin e tij strategjik Co-PLAN, si dhe në bashkëpunim me partnerë të tjerë, në aktivitete të ndryshme në kuadër të eficiencës energjitike vazhdon të jetë një traditë e POLIS.</p> <p>Evidencë Aneks 7. Lista e marrëveshjeve bashkëpunimit.pdf</p> <p>Studentët e programit profesional në Eficiencë Energjitike janë përfshirë në mënyrë aktive:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Panairi “Energjia Sfida e së Ardhmes”, në Tirana EXPO Centre</li> <li>• Seminari Kombëtar “Eficienca e Energjisë në Sektorin e Banesave dhe Përgjigjia në Fushën e Edukimit”</li> <li>• Ndërtimi i Kapsulës Solare</li> <li>• Ndërtimi i laboratorit</li> <li>• Ditët e Kursimit të Energjisë etj;</li> </ul>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit garanton njohuritë e përshtatshme dhe zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit, duke mbështetur diskutimet dhe punën në grup në interpretimin</p>	<p>GVJ në takimet me pedagogët dhe me studentët, konstatoi se angazhimi i tyre në punët në grup, referimet e detyrave, prezantimet perfundimtare para komisioneve që ata marrin nga lëndët teorike edhe praktikatat profesionale krijojnë premisat që të zhvillohen dhe komponentë të tjerë formimi si:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Aftësitë komunikative të studentëve</li> <li>• Aftësitë e punës në grup</li> </ul>




<p>dhe zgjidhjen e problematikave apo çështjeve të caktuara.</p>	<p>Internshipet kanë për qëllim përpos aftësive tekniko-profesionale edhe zhvillimin e aftësive të punës në grup pasi studentët u bashkangjiten grupeve të punës në ndërmarrjet ku kryejne internshipet.</p> <p>Evidencë Aneks 13.2 Format Intershipi.pdf</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale, duke garantuar realizimin në praktikë të marrëveshjeve me punëdhënësit e aktorët e biznesit në përfitim të formimit praktik të studentëve. Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar formimin cilësor dhe për të nxitur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>GVJ konstaton se Universiteti Polis ka një database me bizneset private në vend brenda fushës së programit EE. Në këtë aspekt, Universiteti POLIS dhe programi i studimit ka luajtur edhe një rol sensibilizues dhe ndërgjegjësues në lidhje me eficientë energjike.</p> <p>Evidence Aneks 7. Lista e marrëveshjeve bashkëpunimit.pdf</p> <p>GVJ në vizitën në laboratorët që mbështesin programin profesional të studimit dhe ku studentët marrin njohuritë e thelluara praktike evidentoi një laborator të mirë organizuar me pajisje të kohës dhe sipas standarteve bashkekohore.</p> <p>Evidencë Aneks 21. Lista e pajisjeve të laboratorit EE.pdf.</p> <p>Disa kompani kanë dhënë një kontribut mjaft të rëndësishëm në ndërtimin e laboratorit të HVAC. Përmendim këtu kompaninë "Al-Tek" si dhe kompaninë "VenkonAir", të cilat ishin kompanitë e para që ofruan bashkëpunim.</p> <p>Një aspekt i bashkëpunimit, prej të cilit studentët përfitojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë, është realizimi i mundësisë që studentët të zhvillojnë praktikën profesionale të internshipit pranë këtyre kompanive (mjaft e rëndësishme kjo për një program profesional). Studentët mund të njihen më nga afër me profesionin e tyre si dhe aspekte të cilat nuk kanë mundur t'i njohin në auditor apo në laboratorët e universitetit. Kjo periudhë praktike, do të krijonte edhe mundësi më të mëdha punësimi për të diplomuarit.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Në përfundim të çdo moduli apo lënde, personeli akademik vlerëson, analizon e shqyrton kompetencat dhe aftësitë e fituara nga studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, duke nxjerrë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orientojnë studentët për implementimin e tyre.</p>	<p>Gjatë takimit të GVJ me studentët ata u shprehën që syllabusi respektohet nga pedagogët e lëndëve dhe ata janë në dijeni të pikëve të marra gjat vitit përpara testimit/prezantimit final në çdo lëndë. Ky është pjesë e një procesi të vazhdueshëm, pasi marrëdhëniet dhe kontaktet e stafit akademik me studentët janë të afërta dhe lejojnë mundësi komunikimi, në shërbim të një orientimi sa më efikas të studentëve nga ana e stafit mësimor.</p> <p>Në përfundim të çdo lënde apo moduli pedagogët analizojnë aftësitë e fituara të studentëve gjatë procesit të mesimnxenies Orientimi i studentëve në drejtimin përmirësimit të aftësive u jepen në formë komentesh; çdo student individualisht i komunikohen gjetjet e pedagogut se ku kanë qënë problematikat e studentit edhe si si mund t'i përmirësojnë akoma në vazhdim.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni harton procedura të posaçme, të njohura e publike për diplomimin e studentëve dhe garanton mbështetjen dhe udhëzimin e studentëve në procesin e diplomimit. Ai mban regjistra zyrtarë të studentëve të diplomuar dhe i</p>	<p>Sikundër parashikohet në rregulloren e programit të studimit, studenti që ka plotësuar të gjitha kërkesat e planit mësimor dhe ka përfunduar projektin final, pajiset me diplomën përkatëse, të shoqëruar me suplementin e diplomës, çertifikatën e notave.</p> <p>Evidence Aneks 8. Rregullore Programit të Studimit.pdf, Neni 10.</p> <p>Diploma nënshkruhet nga Dekani i Fakultetit për Kërkim dhe Zhvillim, përgjegjës për programin e studimit dhe nga Rektori i Universitetit POLIS. Secili prej tyre shënon me shkrim dore emrin, mbiemrin, gradën dhe titullin shkencor. Diploma vuloset me vulën e njomë dhe të thatë të Universitetit POLIS.</p>



29



përditëson ata në fund të çdo viti akademik.	<p>Tërheqja e diplomës bëhet personalisht nga i diplomuari, kundrejt nënshkrimit në regjistrin e diplomave. Nëse prania e të diplomuarit është pamundur, tërheqja e diplomës mund të bëhet nga një anëtar i familjes, i pajisur me prokurë të posaçme, duke paraqitur dhe letërnjoftimin e tij.</p> <p>Universiteti ruan në arkivën e tij të dhëna mbi ecurinë e studentëve nga momenti i regjistrimit deri në momentin e diplomimit</p>			
<b>Kriteri 6.</b> Njësia përgjegjëse, personeli akademik dhe udhëheqësit akademikë orientojnë dhe ndihmojnë studentët për përgatitjen e punimit të diplomës, realizimin e veprimtarisë praktike dhe përpunimit të rezultateve, duke garantuar bashkëpunimin edhe me aktorë të jashtëm për realizimin e saj.	<p>Programi Profesional në Eficencën Energjitime i Universitetit POLIS synon të japë njohuri formuese dhe praktike bazë mbi çështje dhe fenomene që lidhen me eficientësinë e energjisë në përgjithësi e sidomos në banesa. Në përmbijlljen e studimeve zhvillojnë një projekt-final i cili në thelb sintetizon të gjitha njohuritë teroike edhe praktike të marra gjatë periudhës 2-vjeçare të studimeve. Në zhvillimin e projektit final studentët mbështeten nga pedagogu përgjegjës si edhe ekspertë të jashtëm të fushës. Projekt-diploma mbrohet përpara një komisioni ku studenti vlerësohet për punën e kryer mbi projekt diplomën. Evidence Aneks 8. Rregullore Programit të Studimit.pdf, Neni 10.</p> <p>Universiteti Polis në kuadër të realizimit të praktikave profesionale dhe për të garantuar një përputhje sa më të mirë të kërkesës së tregut, duke ndjekur edhe eksperiencën ndërkombëtare në programe të ngjashme ka krijuar një rrjet të ngushtë bashkëpunimi me biznesin privat në fushën e eficientësisë së energjisë. Evidence Aneks 7. Lista e marrëveshjeve bashkëpunimit.pdf</p> <p>Kjo bën të mundur që këto kompani të japin një kontribut edhe në procesin e mësimdhënies, nëpërmjet seminareve, prezantimeve apo leksioneve të ndryshme. Nëpërmjet këtyre aktiviteteve synohet afrimi i studentëve me tregun e punës si dhe me prurjet më të reja në teknologjitë e fushës</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

#### IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT DHE MBËSHTETJA E STUDENTËVE

<b>Standardi IV.1 Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për përzgjedhjen dhe cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë eficiente dhe efektive nga ana e tyre</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton dhe zbaton procedura dhe kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura, që garantojnë përzgjedhjen e	Nga takimi I GVJ me Dekanin e Fakultetit për kërkim dhe Zhvillim dhe me përgjegjësin e Departamentit të Kërkimit të Aplikuar përgjegjës për programin profesional në Eficencë Energjitime u vendos theksi që, Universiteti POLIS ndjek një politikë të qartë në drejtim të rekrutimit të stafit akademik. Synim i së cilës është tërheqja e stafit të kualifikuar me grada e tituj shkencor, me

Adresa: "Rruga e Durrësit" Nr. 219 Tiranë



E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)

Tel:+355 [04] 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

30

<p>personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të tij.</p>	<p>eksperiencia në fushën e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor si dhe rekrutimi i stafit administrativ me eksperiencë për pozicionin vakant.</p> <p>Evidenca Aneks 23. Procedura e rekrutimit te personelit.pdf</p> <p>Lidhur me programin 2-vjecar profesional në Eficiência Energjitime, përpos kërkesave sipas akteve nënligjore e kritereve të përgjithshme që Universiteti POLIS zbaton për rekrutimin, stafi duhet të ketë minimalisht kualifikimin, MSc. kryesisht në fushën Inxhinieri Mekanike, Energjitikë, Arkitekturë, etj. Gjithashtu një vëmendje e veçantë i kushtohet punësimit të ekspertëve/profesionistëve me përvojë konkrete e që janë të angazhuar në kompani të ndryshme që operojnë në fushën e energjitikës, energjive të rinovueshme etj. Finalizimi I procedurës së punësimit përmbillet më kontratën e punës ku evidentohen element të ngarkesës mësimore, detyrimeve dhe përgjegjësiive etj.</p> <p>Evidencë 8. Aneks Kontrate.pdf.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program, personin përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtarit në çdo semestër dhe vit akademik, përfshirë tutorët apo vëzhguesit e praktikës në institucionet partnere, si dhe atë të personelit ndihmësmësimit-shkencor dhe administrativ të angazhuar.</p>	<p>Nga takimi I GVJ me Zyrës së Burimeve Njerëzore të universitetit, sikurse parashikohet në legjislacionin në fuqi dhe aktet e brendshme të Universitetit POLIS, dosja për të gjithë personelin akademik të angazhuar në programin e studimit Eficiência Energjitime, së bashku me dokumentacionet e secilit, arkivohen pranë kësaj zyre.</p> <p>Për të gjithë personelin akademik të angazhuar në procesin e mësimdhënies, si ata efektivë ashtu dhe ata me kontratë të pjesshme, U_POLIS plotëson dhe arkivon të gjithë dokumentacionin e nevojshëm me të dhënat personale, dhe kualifikimet e fituara ndër vite të stafit të punësuar.</p> <p>Evidencë Aneks 40. Tabelat permbledhese _ASCAL_EE.pdf</p> <p>Fakulteti për Kërkim dhe Zhvillim disponon gjithashtu ngarkesën e stafit për secilin semestër (orët totale), angazhimin e tij në lëndët përkatëse, si edhe komunikon në mënyrë të vazhdueshme me koordinatoren e programit në lidhje me ecurinë e procesit mësimor. Ky i fundit komunikon me studentët në formë të vazhduar, duke organizuar takime periodike, nëpërmjet të cilave diskutojnë rreth shqetësimeve, kërkesave që studentët mund të shfaqin në lidhje me ecurinë akademike. Një person nga stafi caktohet gjithashtu si vëzhgues i praktikave të studentëve; kjo realizohet përmes vizitave monitoruese që këta të fundit zhvillojnë në kompanitë ku studentët kryejnë praktikat.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimit me karakter profesional dhe për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.</p>	<p>GVJ në vizitën në labororet, bibliotekën dhe mjediset didaktike që mbështesin programin profesional të studimit EE, evidentoi kushtet optimale të mjedisëve ku rëndësi e veçantë i kushtohet mjedisit/zyrave/ambienteve studimore për t'i mundësuar kushtet, logjistikën dhe komoditetin e nevojshëm në mënyrë që të personeli të përmbushin detyrat e tyre kundrejt studentit dhe universitetit në mënyrë profesionale.</p> <p>Fakulteti për Kërkim dhe Zhvillim tregon një kujdes të veçantë në përzgjedhjen dhe angazhimin të stafit (me kohë të plotë &amp; të pjesshme) në përputhje të plotë me ngarkesën e planit mësimor, duke përmbushur objektivat e programit profesional.</p>

	Evidencë Aneks 32. Strategjia e Menaxhimit te Burimeve Njerezore.pdf			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit, përmes organizimit të programeve specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, si dhe mbështetjen për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.	<p>Gjatë takimit të GVJ me pedagogët u evidentua angazhimi I tyre I vazhdueshëm në trajnime dhe kualifikimin e tyre për zhvillim të mëtejshëm profesional (mundësi aplikimi në programin double degree të doktoraturës), si edhe trajnime lidhur me inovacionin në mësimdhënie. Për realizimin e këtyre trajnimeve, POLIS shfrytëzon vazhdimisht projektet ndërkombëtare lidhur me disa trajnime stafit për kërkim shkencor, si edhe parashikon publikimin e manualeve lidhur me këtë.</p> <p>Evidencë <a href="https://driveproject-eu.com/2020/03/31/ëebp-2/">https://driveproject-eu.com/2020/03/31/ëebp-2/</a>.</p> <p>Një mundësi tjetër për kualifikimin e stafit është dhe programi double-degree i Doktoraturës në Arkitekturë dhe Planifikim Urban, i cili ofrohet nga Universiteti POLIS në bashkëpunim me Universitetin e Ferrarës në Itali. Ky program është ndërdisiplinor dhe i hapur kundrejt fushave të tjera, të cilat zhvillojnë ide inovative dhe aplikative. Kjo ka bërë të mundur që edhe stafit i programit EE, t'i ofrohet mundësia e aplikimit si dhe zhvillimit të mëtejshëm dhe kualifikim profesional, në këtë program, sikurse është rasti i koordinatorit të programit të studimit profesional në EE.</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X



#### Standardi IV.2

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të përshtatshëm sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit me karakter profesional**

Kriteret	Vlerësimi
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	<p>GVJ në vizitën në laboratorët, bibliotekën dhe mjediset didaktike që mbështesin programin profesional të studimit EE evidentoi që POLIS ka një strategji institucionale për rritje cilësore dhe sasiore, e cila është materializuar në një kampus modern, i cili mundëson një prej infrastrukturave më moderne në fushën akademike dhe në kërkimin shkencor, duke përfshirë edhe laboratorët e nevojshëm përkatës.</p> <p>Evidencë Aneks 20. Siperfaqet POLIS.pdf</p> <p>Lidhur me programin e studimit profesional Eficiência Energjitime, Universiteti POLIS disponon laboratorin e dedikuar të EE, të pajisur me infrastrukturë të mjaftueshme për mbarëvajtjen e procesit mësimor, pasurimi i mëtejshëm i së cilit dhe përditësimi i tij është prioriteti i universitetit, për nga vetë rëndësia që pjesa praktike zë në këtë program studimi.</p> <p>Evidencë Aneks 21. Lista e pajisjeve të laboratorit EE.pdf</p> <p>Organizimi në fundjava siguron që shfrytëzimi i ambjenteve të disponueshme të jetë maksimal dhe efektiv për studentët e programit të studimit profesional EE.</p>



<p><b>Kriteri 2.</b> Mjediset mësimore, si: klasat, laboratorët, studiot e mjediset e tjera janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion GVJ konstatoi se, universiteti ofron mjedise për zhvillimin e leksioneve teorike dhe klasa e laboratorë, të pajisur me bazën të nevojshme për mësimdhënie; psh: cdo klasë leksionesh është e pajisur me projektorët që ndodhen në çdo auditor, të cilët shërbejnë për shpjegimin e pjesës teorike, ndërkohë që laboratorët e përgjithshëm apo të posacëm kanë të gjitha mjetet dhe teknologjinë për realizimin e procesit të aftësimit praktik.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas fushës specifike të programit profesional, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Programi profesional Eficiência Energjitime ka një laborator të dedikuar të emërtuar “Laboratori i Eficiencës Energjitime” I cili ka një sipërfaqë prej 70m2, I financuar nga projekti Tempus.</p> <p>Pajisjet e laboratorit të Eficiencës Energjitime kryesisht ndahen në dy grupe:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Pajisje didaktike të HVAC (Heating, Ventilation Air Condition System)</li> <li>• Pajisje matjeje dhe testimi të Eficiencës Energjitime, kryesisht të levizshme (portable)</li> </ul> <p>Ky laborator është mjaft i kompletuar dhe kompleks, i ndërtuar në mënyrë të tillë që të akomodojë teknologjinë më bashkëkohore të fushës si dhe t’iu shërbejë nevojave të studentëve. Në këtë laborator studentët kanë mundësi të asimilojnë dhe të vënë në praktikë njohuritë teorike të fituara gjatë orëve të leksioneve. Evidencë Aneks 21. Lista e pajisjeve të laboratorit EE.pdf</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/eve të studimit që ofron.</p>	<p>Laboratori (kriteri 3 me sipër), përmban një impiant HVAC i cili është i lidhur me burime të diversifikuara energjie si kaldaja e drurit, paneli fotovoltaik, pompa termike, rrjetin elektrik në mënyrë që studentët të kenë mundësinë të shikojnë por dhe të praktikohen me të gjitha burimet e energjisë.</p> <p>Laboratori është i kompletuar edhe me pajisjet monitoruese për të mbuluar Auditin Energjitik siç janë termokmerat, anemometrat sensorët termik etj.</p> <p>Gjithashtu në kuadër të lëndës Praktika Laboratorike, studentët mund të praktikojnë lidhjet e kondicionereve, funksionimin, lidhjen e shkëmbyesave termik, rekuperatorët e nxehtësisë etj.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale, internship-it dhe veprimtarive të tjera praktike thelbësore për programet me karakter profesional.</p>	<p>Universiteti POLIS zotëron kapacitetet e duhura infrastrukturore dhe logjistike për mbarëvajtjen e gjithë procesit mësimor të programit profesional në Eficiência Energjitime, me të gjithë komponentët e tij si praktika, ëorkshope, internship, etj.</p> <p>Me qëllim zhvillimin e praktikave profesionale sa më cilësore, POLIS bashkëpunon me një sërë kompani nëpërmjet të cilave studentët jo vetëm përmbushin një detyrim të përcaktuar në planin mësimor, por njëkohësisht fitojnë një eksperiencë konkrete dhe të vlefshme nga ana e praktikës dhe e asaj që do të përballet me tregun e punës pas diplomimit</p>

Shkalla e përbushjes së standardit	Niveli i përbushjes	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

<b>Standardi IV.3</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse e të posaçme të mësimnxënies, bibliotekën e literaturën dhe mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit dhe realizimin cilësor të tij</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit dhe krijon kushte për akses të barabartë e pa pagesë dhe të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.</p>	<p>GVJ gjatë vizitës në institucion konstatoi se Universiteti POLIS disponon një bibliotekë me një hapësirë prej 155 m<sup>2</sup>, e pajisur me infrastrukturën e nevojshme për të ofruar komoditet dhe akses të barabartë dhe pa pagesë për të gjithë studentët.</p> <p>Evidence (<a href="http://www.universitetipolis.edu.al/?q=sq/node/1335">http://www.universitetipolis.edu.al/?q=sq/node/1335</a>).</p> <p>Biblioteka ofron edhe kompjutera, të pajisuar me programet kompjuterike të nevojshme për t'u ardhur në ndihmë studentëve të punojnë në mënyrë të pavarur për detyrat, projektet, etj apo për të studiuar. Duke theksuar faktin që mësimi për EE zhvillohet në fundjavë, kjo iu mundëson atyre akses më të plotë në të gjitha ambientet e universitetit, përfshirë këtu edhe bibliotekën. Shërbimet dhe mjedisin e kësaj të fundit ata e shfrytëzojnë pa asnjë kufizim, por sigurisht duke respektuar rregullat përkatëse.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë mësimore bazë, ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, të mjaftueshme dhe të përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>GVJ gjat vizitës në bibliotekën e institucionit dhe me konkretisht materialeve/dispensave lidhur me programin profesional në Eficientë Energjitike, biblioteka disponon literaturat përkase në përputhje me syllabuset e lëndëve, si edhe materialet/dispensat e përgatitura sipas rastit nga pedagogët, si një mënyrë për t'u ofruar literaturë në gjuhën shqipe studentëve, pasi vetë fusha është pak kufizuese në këtë pjesë.</p> <p>Evidencë Aneks 31. Broshura e bibliotekës.pdf</p> <p>Lista e teksteve/titujve që duhen në secilin vit akademik nxirret nga syllabuset përkatëse dhe i dërgohet dekanit, bibliotekës dhe financës për miratim dhe procedim më tej me blerjet. Aktualisht në bibliotekë ndodhen një numër i konsiderueshëm librash/manualesh/dispensash të fushës së EE, duke shtuar këtu edhe bibliotekat online JSTOR, dhe EBSCO.</p> <p>EBSCO Evidencë (<a href="https://ulibrary.rash.al/">https://ulibrary.rash.al/</a>) dhe</p> <p>JSTOR Evidencë (<a href="http://www.jstor.org">http://www.jstor.org</a>)</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit dhe duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës,</p>	<p>Universiteti POLIS, përveç pjesës së literaturës fizike i ofron studentëve edhe mundësinë e aksesimit të dy bibliotekave on-line, EBSCO dhe JSTOR (Evidence kriteri 2 me sipër).</p> <p>Bibliotekat online përmban gjithashtu një numër të konsiderueshëm tituj librash në fushën e Eficientë Energjitike, të cilat shfrytëzohen nga studentët e programit të EE si literatura bazë ose ndihmëse për lëndët përkatëse, si edhe nga stafi për kërkim shkencor, ngritje profesionale në fushën e tyre të interesit, etj.</p>

<p>përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.</p>	
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni, përmes bashkëpunimit me aktorë të jashtëm, të angazhuar në realizimin e programit mësimor, duhet t'u lehtësojnë dhe garantojnë studentëve mbështetjen dhe përdorimin e burimeve e logjistikës së nevojshme të institucioneve partnere, në varësi të natyrës së angazhimit të tyre në procesin formues teorik, praktik dhe profesional të studentëve.</p>	<p>Bashkëpunimi me aktorë nga biznesi, që operojnë në fushën e Efiçencës Energjitike është shumë i rëndësishëm veçanërisht për programet profesionale, nëpërmjet të cilëve bëhet i mundur realizimi i praktikave profesionale dhe njohja e tregut të punës.</p> <p>Konkretizimi i dijes së përfutur në auditor në ambientet e këtyre kompanive, bën të mundur që studentët të pëballen me sfidat e proceseve praktike, para se ata të diplomohen. Çka i ndihmon studentët të integrohen me lehtësi në tregun e punës.</p> <p>Gjithashtu institucionet/bizneset me të cilat bashkëpunohet krijohet një urrë komunikimi për të kuptuar edhe më konkretisht kurrikulën që programi në Efiçencë Energjitike përmban, nevojat që mund të ketë për rishikimin e saj etj., janë feedback shumë i rëndësishëm për institucionin. Nënshkrimi I memorandumeve të bashkëpunimit me partner strategjik në ven është një ndër prioritetet për këtë program.</p> <p>Evidencë 6. MoU Polis-Swiss.pdf</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni parashikon koston financiare të programit të studimit profesional, mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi dhe raportin financiar të përvitshëm dhe në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi.</p>	<p>Përpara fillimit të çdo viti akademik hartohet buxheti vjetor i programit bazuar në objektivat dhe programin mësimor të shkollës profesionale. Buxheti merr parasysh kërkesën dhe nevojën për burime njerezore akademike dhe administrative, burime infrastrukturore, logjistike dhe investime afatgjata. Plotësimi i nevojës për burime njerezore akademike mund të realizohet nga staf i brendshëm ose i jashtëm.</p> <p>Në 2 vitet e fundit koston e plotë të funksionimit të programit të shkollës profesionale në efikasitet energjie për të dy kurset aktive kanë qenë 4.5 milion leke në vit akademik. Nga këto 60% janë kosto të drejtperdrejta ose kosto akademike dhe 40% janë kosto të tjera administrative dhe didaktike.</p> <p>Në vitin 2016 është investuar dhe është bërë funksional një nga laboratorët më të mirë në fushën e efikasitetit të energjisë me një vlerë rreth 12 milion e 300 mijë lekë ose 90 mijë euro.</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Financimi i një programi studimi profesional duhet të sigurojë e të garantojë mbulimin e të gjitha burimeve dhe veprimtarive të qëndrueshme dhe operative, të lidhura e që janë në funksion të realizimit të programit të studimit, duke garantuar njëkohësisht qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit e në vijim.</p>	<p>Si rezultat i nevojave të tregut të punës për specialist në sektorin e efikasitetit të energjisë programi I ofruar në dy vitet e para të funksionimit të tij, koston e plotë nuk mbulohehin plotësisht nga tarifat e studimit.</p> <p>Aktualisht në programin e studimit të efikasitetit të energjisë koston e plotë operacionale mbulohej në masën 100% nga burimet e veta nëpërmjet tarifave të shkollimit që paguajnë studentet. Ndërsa kostoja e investimit, me konkretisht laboratorin e efikasitetit të energjisë në vlerën prej rreth 12 milion e 300 mijë lekë ose 90 mijë euro është financuar në kuadër të projekteve Tempus të EU si dhe në bashkëpunim me kompani biznesi në fushën e energjisë.</p> <p>Ashtu si në programet e tjera të studimit do të synohet diversifikimi i burimeve të financimit edhe në këtë program studimi.</p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

#### Standardi IV.4

**Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek, zbaton politika e procedura institucionale dhe i jep formacion të plotë e të hollësishëm studentëve mbi programin e studimit me karakter profesional, pranimin, përzgjedhjen, përparimin akademik, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit**

Kriteret	Vlerësimi
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton, zbaton dhe bën publike politika, procedura e kritere të qarta e të kuptueshme për pranimit e studentëve, përparimin e tyre përgjatë kursit të studimit, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit, të cilat garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>Programi profesional në Efçencë Energjitike si një program i nivelit 5 të KSHK realizon pranimet e studentëve bazuar në sipas legjislacionit në fuqi, udhëzimit të MASR, kriteret e pranimit, nga të cilat kuotat dhe tarifat dërgohen nga U_POLIS paraprakisht në MASR, QSHA dhe RASH dhe më pas hidhen në portalin ku studentët bëjnë aplikimin.</p> <p>Evidencë Aneks 46 - Kriteret e pranimit 2021-2022.pdf</p> <p>Lidhur me procedurat dhe kriteret e pranimit të studentëve në shkollën profesionale MRK, ato janë të përcaktuara në Rregulloren e Programit, faqen zyrtare të U_POLIS, rrjetet sociale të universitetit, si dhe në Portalin U-Albania. Ato janë publike dhe përditësohen çdo vit akademik sipas legjislacionit në fuqi.</p> <p>Zyra e Mbështetjes së Studentëve dhe Këshillimit të Karrierës në U_Polis si një njësi e dedikuar për mbështetjen e studentëve, këshillon dhe i mbështët ata, përgjatë gjithë cikleve të studimit dhe më tej.</p> <p>Studentët informohen nëpërmjet një sërë materialesh të printuara si Broshurat për Programet e Studimit, "Guida e studentit", "POLIS @Glance, rrjetet sociale të universitetit, etj. Evidenca Aneks 25.4 Poster në EE.jpg</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të përgjithshme dhe/ose të veçanta për pranimin dhe përzgjedhjen e kandidatëve në programet e studimit me karakter profesional dhe udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me to.</p>	<p>Mbështetur në nenet 5, 6 dhe 7 të Rregullores së Programit të EE përshkruhen kërkesat dhe kriteret për pranimit të studentëve të cilat më pas i deklarohen nëpërmjet komunikimit zyrtar/shkrezor në MASR si dhe përditësohen në Portalin U-Albania.</p> <p>Për V.A 2020-2021 kushteve/kritereve e pranimit për studentë që lejohen të ndjekin studimet në këtë program studimi janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Kanë fituar diplomë të shkollës së mesme ose ekuivalente me to, sipas legjislacionit në fuqi;</li> <li>• Janë fitues midis kandidatëve aplikantë brenda kuotave të pranimit të paracaktuara çdo vit nga U_POLIS, të cilat shpallen në mjediset e dukshme, në faqen zyrtare të universitetit si dhe në Portalin e Maturës Shtetërore (U-Albania) në përputhje me Udhëzimin e MASR;</li> <li>• Kanë mesataren minimale të përcaktuar çdo vit nga MASR;</li> <li>• Nuk janë të regjistruar njëkohësisht ose të regjistruhen më pas në programe të tjera studimi.</li> </ul>

	Gjithsesi kriteret e pranimit janë subjekt rishikimi për çdo vit akademik.
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve, zhvillimin e veprimtarive praktike e profesionale të programit dhe institucionet bashkëpunuese në këto veprimtari, vlerësimin të dijeve e aftësive të studentëve dhe diplomimit.	Gjatë takimit të GVJ me studentët ata u shprehen se u vihet në dispozicion gjithë informacioni i nevojshëm dhe i detajuar në lidhje me strukturën institucionale dhe programin e studimit që ata janë duke ndjekur, konkretisht programin profesional në Efiçencë Energjitike.  Kjo bëhet e mundur nëpërmjet materialeve të printuara si (POLIS @ a Glance, Guida e studentit, Rregullore e Përgjithshme, Rregullore Didaktike, Rregullore e Programit të Studimeve në Efiçencë Energjitike etj.) të cilat janë të përgatitura posaçërisht për studentët e rinj. Këto materiale mbajnë informacione në lidhje me rregulla të brëndshme të universitetit, organizimin e programit, ndarjen e lëndëve sipas tipeve të veprimtarive, kriteret e kalueshmërisë, etj.
<b>Kriteri 4.</b> Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin, kohëzgjatjen e programit të studimeve, mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	Gjatë takimit të GVJ me studentët ata u shprehen se eksperiencia praktike e fituar ka gjetur hapësirat e nevojshme në tregun e punës. Nga takimi rezulton se pjesa e madhe e studentëve janë të integruar në tregun e punës që në vitin e dytë të studimeve.  Evidencë Aneks 29, Raport vjetor per studentet Alumni.pdf  Në këtë aspekt, gjatë formulimit dhe zbatimit të programit të studimit është bërë një ndërthurje ndërmjet eksperiencës europiane në efiçencë energjitike dhe arsim profesional, si dhe praktikës apo eksperiencës lokale shqiptare në këtë drejtim; nga përvoja e deritanishme dhe feedbacku i studentëve të punësuar kjo rezulton të ketë qenë efikase dhe produktive.
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen, veprimtaritë formuese dhe informacion të gjerë e të përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	Gjatë takimit të GVJ me studentët ata u shprehen si informohen në javën e parë të fillimit të vitit akademik lidhur me kohëzgjatjen e programit të studimit, lëndët dhe mënyrën se si ato do të zhvillohen, orari mësimor, prezencat në leksione, laboratorë, praktike etj. Njësitë kryesore akademike dhe administrative të universitetit të cilat informojnë në kontakt direkt studentët por edhe nëpërmjet sistemit elektronik ESSE3, si dhe në faqen zyrtare të universitetit studentët.  Ky informacion shoqërohet edhe nga “Guida Studentore” e cila gjithashtu ka të përfshirë elementët kryesorë organizativë të programit të studimit.  Evidenca EE_al.pdf (universitetipolis.edu.al)
<b>Kriteri 6.</b> Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	Universiteti POLIS ka në dispozicion të studentëve një sistem të posaçëm për manaxhimin e informacionit të tyre akademike (ESSE3).  Evidencë <a href="https://www.upolis.esse3.u-gov.rash.al/Home.do">https://www.upolis.esse3.u-gov.rash.al/Home.do</a>  Ky sistem i ofron studentëve mundësinë e aksesimit të informacionit për programin ku ata studiojnë si: planin mësimor i programit, informacion në lidhje me lëndët, ngarkesën mësimore, frekuentimin, syllabuset e detajuara për secilën lëndë, materialet mësimore, oraret, datat e provimeve, objektivat e kurseve, sistemi i vlerësimit, notat, etj.  Të gjitha këto të dhëna aksesohen nga studenti nëpërmjet kredencialeve personale të gjithsecilit, jo vetëm nga brenda U_POLIS, por edhe jashtë tij në çdo kohë.

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

#### Standardi IV.5

**Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit me karakter profesional**

Kriteret	Vlerësimi
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomimin e daljen në tregun e punës.</p>	<p>Gjatë takimit të GVJ me studentët ata u shprehën se janë familjarizuar me sistemin e menaxhimit të llogarisë studentore nëpërmjet sistemit ESSE 3. Që në momentin e regjistrimit në U_POLIS, studentëve iu vihen në dispozicion kredencialet për të aksesuar sistemin përmes faqes zyrtare. Në sistem ruhet dhe dokumentohet ecuria e tyre e vazhdueshme për secilën lëndë të planit mësimor, duke filluar me informacionin për lëndën (syllabusi, kreditet, semestri, viti, etj), shpërndarja e pikëve të vlerësimit të vazhduar gjatë vitit (frekuentimi, detyra, projekti, prezantime, provimi final), totali i pikëve, notat, etj.</p> <p>Evidenca Aneks 16.4 Prezantim_menyrë e vlerësimit.pdf</p> <p>Ky sistem shërben edhe si një ndërfaqe e komunikimit midis pedagogut të lëndës dhe studentëve. Përmes këtij sistemi studentët kryejnë gjithashtu procedurën e vlerësimit të pedagogëve, e cila, siç është trajtuar në kriteret e mëparshme, e cila menaxhohet në mënyrë anonime e menaxhohet nga NJBSC</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrojnë informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe të partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>Sistemi ESSE 3 I menaxhimit të brendshëm, përveç pjesës së studentëve përmban disa rubrika; si psh Stafit Akademik, Personeli Ndihmës Mësimor-Shkencor, Personeli Administrativ, etj; këto rubrika përfshijnë të gjithë informacionin dhe dokumentacionin e lidhur me stafin akademik, atë administrativ dhe ndihmës, të përfshirë në programin e studimit në programin profesional në EE.</p> <p>Fillimisht, stafit akademik të angazhuar në këtë program studimi, i hapet një llogari në sistem nga Zyra e Burimeve Njerëzore dhe më pas i komunikohen kredencialet e aksesit të shoqëruara me manualin e përdorimit të sistemit.</p> <p>Vetë universiteti arkivon pranë zyrës së Burimeve Njerëzore gjithë dokumentacionin e nevojshëm si në format elektronik ashtu dhe fizik.; këto përfshijnë arritjet akademike, kualifikimet, aktivitetet kërkimore shkencore etj., për stafin akademik të përfshirë në këtë program studimi, dhe jo vetëm.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Në sistemin e menaxhimit të U_POLIS ruhen të gjitha të dhënat personale, për çdo pedagog të angazhuar në programin EE; secili prej tyre akseson sistemin me kredencialet që i vihen në dispozicion. Nëpërmjet sistemit stafi akademik, hedh vlerësimet e vazhdueshme të studentëve, vlerësimet e ndërmjetme si edhe ato finale, përditësojnë syllabuset, gjenerojnë procesverbalet etj.</p> <p>Nga ana tjetër, studentët mund ta aksesojnë sistemin e menaxhimit përmes faqes zyrtare të U_POLIS. Ata kanë akses për të parë syllabuset e lëndëve,</p>

	orarin, mungesat, vlerësimet gjatë vitit, notat përfundimtare, njoftime të ndryshme nga sekretaria, etj.								
<b>Kriteri 4.</b> Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.	Për sa i përket komunikimit dhe shkëmbimit të literaturës, materialeve mësimore etj. Universiteti POLIS, përdor platformën Google Classroom, ku secili pedagog ka mundësi të ketë një hapësirë/klasë virtuale të dedikuar për çdo lëndë. Kjo bën të mundur që studentët të aksesojnë materialet didaktike në kohë reale. Suksesi i përdorimit të platformës Google Classroom u vërtetua edhe gjatë kohës së pandemisë COVID-19.								
<b>Kriteri 5.</b> Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.	Sipas nevojave institucionale, nga sistemi mund të gjenerohen raporte statistikore të kategorive të ndryshme, si numri i studentëve për çdo program studimi, kalueshmëria e studentëve për çdo lëndë studimi, si dhe raporte të tjera sipas qëllimit për monitorimin dhe analizimin e cilësisë akademike të studentëve, në periudha të ndryshme të vitit akademik, nga organet drejtuese si dekanat ose rektorat								
<b>Kriteri 6.</b> Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik dhe aktivitetet e ndryshme publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë ku të paktën njëra prej tyre është gjuha shqipe.	Në faqen zyrtare të Universitetit POLIS janë të publikuara dhe përditësohen vazhdimisht informacionet lidhur me programin e studimit Efiçencë Energjitike. Tek rubrika e Programeve të Studimit është publikuar informacion i përmbledhur lidhur me organizimin, kohëzgjatjen dhe kreditet e programit, si edhe tarifën e studimit. Gjithashtu, përshkruhet shkurtimisht profili i studimit, duke theksuar aspektin praktik të tij, temat kryesore, mundësitë për punësim të studentëve pas diplomimit, duke bashkangjitur edhe planin mësimor, me lëndët e grupuara sipas Tipeve e Kategorive të Veprimtarive.  Evidencë <a href="http://www.universitetipolis.edu.al/?q=sq/node/33">http://www.universitetipolis.edu.al/?q=sq/node/33</a>  Evidencë Aneks 16.4 Prezantim_menyrja e vleresimit.pdf								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përmbushet plotësisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet asnjëherë</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet asnjëherë				X
Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet asnjëherë						
			X						

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përmbushet plotësisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet asnjëherë</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet asnjëherë				X
Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet asnjëherë						
			X						

## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

**Standardi V.1** Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin, në programin e studimit dhe i vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit

Kriteret	Vlerësimi
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton dhe zbaton politika, procedura dhe kritere të pranimit, përparimit, të	Në dokumentat e vendosura ne dispozicion të GVJ sic është Rregulloren Didaktike dhe Rregullores së Programit në Eficencë Energjitik përcaktohen politikatat, procedurat dhe kriteret e pranimit të studentëve në programet e

Adresa: "Rruga e Durrësit" Nr. 219 Tiranë

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)

Tel: +355 [04] 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

39

<p>transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit të studentëve, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore dhe që janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>studimit që U_Polis ofron. Në to përfshihen qartë dispozitat e përgjithshme, aplikimi, pranimi, transferimi, etj, të hartuara në përputhje me legjislacionin dhe aktet rregullatore në fuqi.</p> <p>Evidenca Aneks 8. Rregullore Programit të Studimit.pdf; Evidencë Aneks 17. Rregullore Didaktike.pdf</p> <p>Konkretisht për programin e shkollës profesionale, në EE këto procedura dhe kritere janë të pasqyruara në Nenet 5, 6 &amp; 8 të Rregullores së Programit në Eficencë Energjitike, ku trajtohen kërkesat dhe kriteret për regjistrim, si edhe procedura e transferimit të studimeve</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje dhe orientimin drejt tregut të punës, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Zyra e Mbështetjes së Studentëve dhe Këshillimit të Karrierës (ZMSKK) asiston dhe ndjek studentët, si gjatë kohës së studimeve, ashtu edhe pas mbarimit të saj, duke krijuar një database me të dhëna për karrierën e studentit duke i asistuar dhe mbështetur të gjithë ata në cdo kohë dhe pa asnjë përjashtim.</p> <p>Evidencë <a href="http://www.universitetipolis.edu.al/?q=sq/node/57">http://www.universitetipolis.edu.al/?q=sq/node/57</a></p> <p>ZMSKK konsulton me studentët në lidhje me arritjet si dhe vështirësitë që ata mund të hasin gjatë përshtatjes në treg, lobimin për mbrojtjen e te drejtave të profesionit, pjesëmarrje aktive në konkurse dhe aktivitete me fokus profesional por dhe social, ruajtjen e lidhjes me POLIS përmes Shoqatës ALUMNI, inkurajimin e frymës së bashkëpunimit si komunitet dhe mbështetjes etj.</p> <p>Në këtë formë gjatë gjithë jetës universitare studentët kanë informacionin, ndihmën dhe këshillimin e nevojshëm përmes burimeve informative dhe strukturave përgjegjëse të U_POLIS.</p> <p>Evidencë Aneks 24. Broshura Raport Alumni 2016-2019.pdf</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve dhe, përpara fillimit të çdo viti akademik, udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>Lidhur me procedurat dhe kriteret e pranimit të studentëve në shkollën profesionale MRK, ato janë të përcaktuara në Rregulloren e Programit, faqen zyrtare të POLIS, rrjetet sociale të universitetit, si dhe në Portalin U-Albania. Ato janë publike dhe përditësohen çdo vit akademik sipas legjislacionit në fuqi dhe dhe iu komunikohen kandidatëve potencialë gjatë vizitave paraprake në universitet.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve, kalimit nga një vit akademik në tjetrin, procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjeshme.</p>	<p>Gjatë takimit të GVJ me studentët ata u shprehën se janë në dijeni të kriterëve për kalimin nga njëri vit në tjetrin, kriteret skualifikuese/ penalizuese për kalimin në lëndët që zhvillojnë. Nga ana tjetër në Rregulloren Didaktike përcaktohen kushtet e kalimit të studentëve në vitin pasardhës të studimeve. Për programin e shkollës profesionale Eficencë Energjitike këto janë si më poshtë.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Për të gjitha programet e studimit, studenti i vitit të parë kalon në vitin e dytë nëse ai ka marrë jo më pak se 50% të krediteve (30 kredite) të vitit të parë.</li> </ul>



	<ul style="list-style-type: none"> <li>Për studentët që transferohen në një nga programet e studimit të Universitetit POLIS, për të përllogaritur vitin në të cilin kandidati transferohet zbatohet vetëm kriteri i numrit total të krediteve të marra.</li> </ul>								
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësi të studentëve në programin e studimit dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Gjatë takimit të GVJ me studentët u theksua që pëdagogët respektojnë syllabuset e lëndëve së bashku me elementet përbërëse të vlerësimit sikurse janë frekuenca, detyra kursi, provim i ndërmjetëm, projekt, provim final, etj.</p> <p>Studentët njihen me mënyrat e vlerësimit që në orën e parë të zhvillimit të lëndës, ku iu prezantohet syllabusi i lëndës me të gjitha elementet përbërës.</p> <p>Gjithashtu duke qënë se programi zgjat vetëm dy vite akademike, studentëve iu bëhet e qartë edhe procedura që ndjekin për tu diplomuar në kohë dhe me rezultate të larta, informacion të cilin studentët mund ta gjejnë në Rregulloren e Programit, faqen zyrtare të POLIS, rrjetet sociale të universitetit</p>								
<p><b>Kriteri 6.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>Gjatë takimit të GVJ me përfaqësues të institucionit u evidentuan përdorime të ndryshme të kanaleve të komunikimit si ato online por edhe pjesmarrja sistematike e U_POLIS në panairt e ndryshme në kuadër të këshillimit të karrierës. Përpos rrjeteve sociale (facebook, Instagram, linkedin), ku shpërndan vazhdimisht informacione lidhur me përshkrimin e degës, mundësitë e punësimit, mënyrën se si ajo zhvillohet në POLIS, bursat e ofruara, etj informacion i plotë publikohet edhe ne faqen zyrtare të universitetit.</p> <p>Komunikimi në mënyrë të drejtpërdrejtë, shpërndarja e broshurave (të cilat përmbajnë informacion me specifikat e kurrikulës dhe objektivat formuese të programit EE) bën të mundur një vizibilitet më të drejtpërdrejtë të Universitetit POLIS tek kandidati i interesuar.</p> <p>Evidencë Aneks 25 Programi Profesional në EE.jpg</p>								
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th></th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

**Standardi V.2 Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit**

Kriteret	Vlerësimi
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni informon në mënyrë të hollësishme studentët për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve dhe ve në dispozicion të tyre, informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese të programit të studimit me karakter profesional.</p>	<p>Gjatë takimit të GVJ me përfaqësues të institucionit u evidentu se kandidatët/studentët që në ditët e para të interesimit/pranimit njihen me organizimin dhe strukturimin e programit me leksionet që zhvillohen ne fundjavë, kurrikulën e studimeve, ku iu komunikohen të gjitha lëndët e kurrikulës, kohëzgjatja 2 vjeçare e programit dhe fakti që konsiston në 120 kredite në total, në përputhje me Rregulloren e Programit. Evidencë Aneks 8. Rregullore Programit të Studimit.pdf</p> <p>Shpërndarja e informacionit bëhet nëpërmjet kanaleve te ndryshëm te komunikimit si rrjetet sociale, faqja zyrtare e U_POLIS, vizitat në ambjentet</p>

	<p>e U_POLIS, pjesmarrja në panairët e organizuara nga MASR, mbi informimin e kandidateve potencialë, etj</p> <p>Evidencë <a href="http://www.universitetipolis.edu.al/?q=sq/node/33">http://www.universitetipolis.edu.al/?q=sq/node/33</a></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni informon studentët mbi praktikat profesionale në kuadër të realizimit të programit të studimit, partnerët dhe institucionet bashkëpunuese ku parashikohen të realizohen, si dhe mundësitë e punësimit e mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës.</p>	<p>Gjatë takimit të GVJ me studentët mbi praktikat profesionale ata informohen dhe janë shumë të interesuar për intershipe dhe kontakte me kompanitë që janë të interesuara për ekspert të fushës. Studentëve iu shpjegohet Praktika Laboratorike, mënyra e kryerjes së Internshipeve si edhe Projekti Final të cilat përbëjnë një pjesë shumë të rëndësishme formuese të programit të studimit Eficencë Energjitike.</p> <p>Për të lehtësuar sa më shumë këtë proces dhe realizimin e tyre në mënyrë sa më cilësore, universiteti ka nënshkruar kontrata bashkëpunimi me biznese/institucione që operojnë në fushën energjitike. Kjo u komunikohet studenteve si një mënyrë lidhëse që ta kenë sa më të lehtë realizimin e këtyre detyrimeve, por ata janë të lirë dhe mund të zgjedhin një biznes/institucion tjetër jashtë listës së bashkëpunimeve të universitetit ku po me të njëjtin seriozitet mund të kryejnë intershiptet dhe praktika profesionale detyruese dhe jo vetëm. POLIS garanton edhe në këto raste zhvillimin e praktikave në respektim e përputhje të plotë me kritere e kërkesat që zbatohen në rastet e tjera.</p> <p>Evidencë Aneks 7. Lista e marrëveshjeve bashkëpunimit.pdf</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Studentëve u vihet në dispozicion informacioni i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Gjatë takimit të GVJ me studentët mbi zhvillimin e procesit mësimor ata u shprehën se informacioni është i shprehur qart dhe i afishuar në disa hapsira informuese në Universitet por edhe online.</p> <p>Para fillimit të procesit mësimor publikohet kalendari i zhvillimit të mësimor (ku specifikohet dita, data, orët, lënda, pedagogu dhe salla), i cili në rast ndryshimi, përditësohet menjëherë dhe shpërndahet me studentët nga koordinatori i programit.</p> <p>Përpos kalendarit të zhvillimit të procesit mësimor studentët prezantohen me ambientet e Laboratorit, me rregullat përdorimit të aparaturave, me auditorët etj.</p> <p>Gjatë vizitave fillestare nëpër kampus, ata njihen me të gjitha shërbimet e tjera që shkolla ofron, duke filluar me kancelarinë, sekretarinë, zyrën juridike, bibliotekën, kantinën, etj, si edhe prezantohen me personat e kontaktit për secilën prej tyre, në rast se duan të përfitojnë shërbimet në fjalë</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p>	<p>Sistemi i menaxhimit të brendshëm (ESSE3) disponon të gjithë informacionin e nevojshëm lidhur me programin e studimit EE. Aty ngarkohet kurrikula e programit në çdo fillim viti akademik në përputhje me matricën ku jepet informacioni i detajuar për çdo lëndë (emri i lëndës, kodi, kreditet, pedagogët, shpërndarja e krediteve sipas komponentëve të lëndës, lloji i saj, lidhja me grupin e studentëve, etj). Këto plotësohen dhe modifikohen tek rubrikat Menaxhimi i Kurrikulës - Lista e lëndëve dhe moduleve. Gjithashtu, stafi përkatës ngarkon dhe azhuron syllabuset e çdo lënde për të cilën është përgjegjës, duke i bërë të disponueshme dhe transparente për studentët</p>

Shkalla e përbushjes së standardit	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
			X

### Standardi V.3

**Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit me karakter profesional, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm**


Kriteret	Vlerësimi																												
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve në vitet paraardhëse në programin e studimit.</p>	<p>Gjatë takimit të GVJ me përfaqësues të sekretarisë mësimore u konfirmua se egziston databasa dhe statistika lidhur me regjistrimin e studentëve dhe diplomimin e tyre që nga hapja e këtij programi studimi. Rezulton se janë diplomuar gjithsej 165 studenmtë në këtë program që nga hapja e tijë.</p> <p>Këto statistika përmbajnë informacione të ndryshme si raporti i studentëve që rregjistrohen me studentet që diplomohen, shpërndarja gjeografike e studenteve, mesatarja me të cilën rregjistrohen ne raport me mesataren që diplomohen, si dhe të dhëna mbi progresin e studentëve në vite, e deri në diplomim, etj.</p> <p>Evidencë Aneks 27. Të dhëna statistikore për studentët e diplomuar.pdf</p>																												
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni disponon dhe ruan statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar, tërheqet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>Gjatë takimit të GVJ me përfaqësues të sekretarisë mësimore u konfirmua se egziston gjithashte databasa dhe statistika lidhur me numrin e studentëve të regjistruar, tërheqet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th>Viti Akademik</th> <th>Nr i studentëve te regjistruar per here te pare</th> <th>Mestarja ne Hyrje</th> <th>Te Diplomuar (Sipas Brezave)</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>2015-2016</td> <td>41</td> <td>6.17</td> <td>24</td> </tr> <tr> <td>2016-2017</td> <td>63</td> <td>5.89</td> <td>44</td> </tr> <tr> <td>2017-2018</td> <td>76</td> <td>5.73</td> <td>53</td> </tr> <tr> <td>2018-2019</td> <td>31</td> <td>5.88</td> <td>17</td> </tr> <tr> <td>2019-2020</td> <td>20</td> <td>6.2</td> <td>-</td> </tr> <tr> <td>2020-2021</td> <td>22</td> <td>6.08</td> <td>-</td> </tr> </tbody> </table> <p>Evidencë Aneks 28. Të dhëna statistikore për studentët e regjistruar.pdf</p>	Viti Akademik	Nr i studentëve te regjistruar per here te pare	Mestarja ne Hyrje	Te Diplomuar (Sipas Brezave)	2015-2016	41	6.17	24	2016-2017	63	5.89	44	2017-2018	76	5.73	53	2018-2019	31	5.88	17	2019-2020	20	6.2	-	2020-2021	22	6.08	-
Viti Akademik	Nr i studentëve te regjistruar per here te pare	Mestarja ne Hyrje	Te Diplomuar (Sipas Brezave)																										
2015-2016	41	6.17	24																										
2016-2017	63	5.89	44																										
2017-2018	76	5.73	53																										
2018-2019	31	5.88	17																										
2019-2020	20	6.2	-																										
2020-2021	22	6.08	-																										
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi deri në diplomimin e tyre, përfshirë punësimin eventual të tyre.</p>	<p>Ecuria e studentëve që nga hapja e programit dhe në vazhdim, reflektohet përmes vlerësimeve të hedhura në sistem nga pedagogët përkatës. Ky proces ndiqet deri në diplomimin e tyre dhe më pas studentët e diplomuar bëhen pjesë e Shoqatës Alumni; në lidhje me këta të fundit, ZMSKK harton një raport vjetor, i cili përmban dhe përmbledh të dhëna të detajuara lidhur me punësimin, cilësinë e punësimit, përputhshmërinë e vendit dhe natyrës së punës në raport me formimin profesional dhe ecurinë e studentëve pas diplomimit.</p> <p>Evidencë Broshura Alumni.pdf</p>																												

<p><b>Kriteri 4.</b> Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Kryesisht menaxhimi i pjesës më të madhe të statistikave përdoret nga Sekretaria për menaxhimin e statistikave dhe shpërndarjen e tyre tek personat e autorizuar aponë përgjigje të kërkesave specifike të organeve dhe autoriteteve drejtuese të POLIS sipas natyrës dhe qëllimit të përdorimit të tyre. Gjenerimit automatik i të gjitha statistikave të kërkuara nga personat/njësitë e autorizuar nga MASR apo institucionet përkatëse bëhet I mundur nëpërmjet sistemit</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe të shkallës së cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p>	<p>Sekretaria Mësimore, harton statistika lidhur me cilësinë në dalje të studentëve, duke i krahasuar me ato cilësinë (mesataren) në hyrje për të kuptuar më mirë ecurinë e procesit dhe nevojat për përmirësime të mëtejme. Po ashtu Universiteti disponon statistikat mbi cilësinë në hyrje të studentëve (mesatarja në hyrje, shkollat nga vijnë, etj).</p> <p>Njësia përgjegjëse për ndjekjen e studentëve (ZMSKK) gjatë dhe pas periudhës së studimeve 2-vjeçare, në përfundim të ciklit të tyre gjeneron statistika dhe raporte lidhur me punësimin e tyre dhe se sa ky punësim përkon me profilin e tyre të studimit me EE.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

**Standardi V.4**

**Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre**

<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.</p>	<p>Statusit të U_POLIS u jep të drejtën studenteve të organizohen për tu përfaqësuar në organet vendimmarrëse të universitetit. Në Universitetin POLIS, studentët organizohen në Senatin e Studentëve, i cili është organizim i pavarur, që nuk zhvillon aktivitete politike dhe ekonomike.</p> <p>Evidencë <a href="http://www.universitetipolis.edu.al/?q=sq/node/56">http://www.universitetipolis.edu.al/?q=sq/node/56</a></p> <p>Studentët e të gjitha programeve të studimit, përfshirë këtu edhe programin EE që ofron Universiteti POLIS, janë të përfaqësuar në këshillin studentor.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose e përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>Senati Akademik, në të cilin janë të përfaqësuar tre studentë, një për secilin fakultet. Rrjedhimisht edhe për programin EE, përfaqësimi i tyre bëhet nga përfaqësuesi i studentit të Fakultetit për Kërkim dhe Zhvillim, për këtë fakultet përfaqësues i studentëve në Senatin Akademik është studente e doktoratës.</p> <p>Mendimi dhe vlerësimi i studentëve mbi proceset akademike, referuar edhe raportit të vlerësimit të brendshëm (RVB) ka pasur në grupin e punës përfaqësuesi të studentëve.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të</p>	<p>Nga dokumentat e vendosura në system në dispozicion të GVJ evidentohet pyetësor lidhur më mendimin e studentëve për aktivitetet akademike mesimdhënëse.</p>



studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.	Evidencë Aneks 16. Vleresim nga studenti per pedagogun.pdf Universiteti POLIS, ka një proktikë të konsoliduar për sa i përket përmirësimit të kurrikulës, duke marrë në konsideratë edhe opinionin e studentëve të diplomuar. Evidencë Aneks 30. Pyetesor Alumni.pdf								
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe të reflektojë sugjerimet e kontributin e tyre në to.	Gjatë takimit të GVJ me studentët dhe pedagogët u evidentua se Koordinator i Programit dhe përfaqësues nga Dekanati, zhvillojnë takime me studentët e shkollës profesionale EE me fokus ecurinë e semestrit; vlerësimi i kushteve laboratorike: nevoja për përmirësime bazuar në pritshmëritë e studentëve ndaj programit etj. Në reflektim të këtyre opinionëve, në fillim të cdo viti akademik, në kuadër të rishikimit dhe përditësimit të kurrikulave në masën e përcaktuar ligjërish, shtrohet për diskutim me studentët çështja e lëndëve të reja që ata shikojne të nevojshme për formimin e tyre profesional.								
<b>Kriteri 5.</b> Studentëve u mundësohet të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	Studentët njihen me procedurën e ankimimit dhe të drejtat apo detyrimet e tyre të përcaktuara në Nenin 7 të Rregullores së Programit që në fillim të vitit akademik. Referuar Rregullores Didaktike pas shpalljes së rezultateve Studenti ka të drejtë të kontestojë vlerësimin e marrë. Në rast kontestimi, ngrihet një Komision Vlerësimi i cili shqyrton ankesat e studentëve, dhe jep vlerësimin përfundimtar të lëndës.  Studentët e programit profesional në EE mund të shprehin mendimin e tyre përmes plotësimit të pyetësorit nga sistemi për vlerësimin e pedagogut sipas mendimit të tyre. Kjo procedurë ndiqet dhe analizohet nga NJSBC.								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përbushet plotësisht</th> <th>Përbushet pjesërisht</th> <th>Përbushet kryesisht</th> <th>Përbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Përbushet plotësisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht				X
Përbushet plotësisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht						
			X						

#### Standardi V.5

**Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët**

Kriteret	Vlerësimi
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.	Zyra e Mbështetjes së Studentëve dhe Këshillimit të Karrierës (ZMSKK) është njësia e ngritur pranë Universitetit POLIS me qëllim informimin dhe mbështetjen e studentëve gjatë periudhës së studimit në POLIS, informimin e tyre lidhur me procesin mësimor, këshillimin për praktikat profesionale gjatë kësaj periudhe, ndërmjetësim dhe këshillim për gjetjen e punës pas përfundimit të ciklit 2-vjeçar të programit profesional në EE.  Gjatë jetës studentore studentët informohen rreth proceseve akademike dhe administrative nëpërmjet, sistemit ESSE3, Guides së Studentit, si dhe njoftimeve të vazhdueshme që marrin nga Sekretaria Mesimore dhe Dekanati i Fakultetit për Kërkim dhe Zhvillim, në rrugë elektronike, apo dhe komunikime të drejtpërdrejta në klasë

	<p>Evidencë <a href="http://www.universitetipolis.edu.al/?q=sq/node/66">http://www.universitetipolis.edu.al/?q=sq/node/66</a></p> <p>Evidencë Aneks 10. Guida e Studentit.pdf</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Në institucion është ngritur dhe funksionon një sistem i posaçëm për mirëpritjen, informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe ndihmesën e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>Këshillimi dhe ndjekja e studentëve përgjatë rrugës së formimit akademik realizohet nga disa aktorë dhe njësi në U_POLIS:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Së pari përmes personave përgjegjës për ecurinë e procesit akademik (Dekanati, Sekretaria Mësimore)</li> <li>• Së dyti përmes shërbimit të tutoratit që zakonisht e ofrojnë koordinatori i programit të studimit</li> <li>• Së treti përmes ZMSKK dhe personave të koordinuar përmes saj, siç do të trajtohet edhe më poshtë, si ish studentë të diplomuar e të punësuar, ose drejtues e menaxherë të kompanive të rëndësishme, të profilizuara në fushat përkatëse të interesit sipas programeve të studimit.</li> </ul>
<p><b>Kriteri 3.</b> Përmes zyrës/njesisë për këshillimin e karrierës, institucioni mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm lidhur me plotësimin e detyrimeve të procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>Zyra e Mbështetjes së Studentëve dhe Këshillimit të Karrierës (ZMSKK) informon studentët me transparencë të plotë për çështjet dhe aspektet akademike, mësimore, si edhe me të drejtat dhe detyrat e tyre. Ajo orienton studentët drejt zgjedhjes së fushave specifike formuese sipas profilit të tyre dhe i njeh ata me mundësitë që universiteti ofron.</p> <p>Gjithashtu, informon studentët lidhur me tregun e punës dhe mundësitë që ai ofron, duke luajtur rolin e ndërmjetës në këtë mes.</p> <p>Evidencë <a href="http://www.universitetipolis.edu.al/?q=sq/node/57">http://www.universitetipolis.edu.al/?q=sq/node/57</a></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit, ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse dhe merr masa për përmirësimin e shkallës dhe cilësisë së punësimit të tyre.</p>	<p>Qëllimi ZMSKK si strukturë në vetvete është i orientuar drejt mbajtjes së kontaktit të vazhdueshëm si dhe dhënies së informacionit shumëdrejtimesh. Informacioni përmbledh informacion për studime, programe të ndryshme, orientim për karrierën ose orientimin profesional si dhe këshillim individual ose në grup. Kjo zyrë bashkëpunon ngushtë me drejtuesit e Shoqatës Studentore dhe të Shoqatës Alumni.</p> <p>Kjo zyrë ka si qëllim:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Të mbajë kontakte individuale me studentët edhe pas diplomimit e punësimit të tyre duke marrë në mënyrë të vazhduar feedback-un e tyre;</li> <li>• Të kryejë studime të përditësuara të tregut të punës dhe identifikimin e kërkesave të tij dhe t'i vërë ato në dispozicion të studentëve;</li> <li>• Rregullon dhe siguron përfshirjen e studentëve në vendimmarrje, në proceset e aktivitetet kryesore që lidhen me mësimdhënien dhe aktivitetet e tjera kërkimore e zhvilluese si dhe shërbimet që u ofrohen.</li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>Të trajnojë studentët për mënyrën e aplikimit për intershipe/punësime në institucione të ndryshme dhe mënyrës së hartimit dhe përgatitjes së dokumentacinit të nevojshëm për aplikim.</li> </ul>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përbushet plotësisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Përbushet plotësisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

**Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit me karakter profesional në “Efiçencë Energjitike” të Universitetit “POLIS”**

**Pikat e forta dhe afirmime**

- Rëndësia dhe kërkesa për formim profesional në këtë fushë i mundëson studentëve të programit profesional në “Efiçencë Energjitike” (EE) integrimin e shpejtë në tregun e punës.
- Programi me karakter profesional në “Efiçencë Energjitike” (EE) është një ndër tre programet e para me karakter profesional në Shqipëri dhe i pari në këtë fushë që i është nënshtruar një procesi akreditimi si program studimi.
- Realizimi i këtij programi studimi në kuadër të një programi European Erasmus ka mundësuar krijimi i një laboratorit të dedikuar për këtë program studimi, i cili përdorej më tej dhe për kursin formimit të vazhduar të Auditimit të Energjisë
- Ngritja e një infrastrukture profesionale laboratorike, laboratorit modern HVAC i mundëson studentëve krijimin e kompetencave praktike.

**Pika të dobta**

- Personeli akademik efektiv duhet të mbajë ngarkesë më të madhe mësimore, në mënyrë që të plotësojë standardin shtetëror të ngarkesës mësimore, ku minimum 70% duhet të mbulohet nga PAE.
- Për shkollën profesionale mbetet gjithmonë problemi i literaturës se posaçme për këtë program në gjuhën shqipe.

**Rekomandime:**

- Marketingut të programit për njohjen dhe ndërgjegjësimin e të interesuarve për vetë vlerën që ka formimi i profesionistëve në këtë fushë, në rang vendi.
- Mundësitë e krijimit të marrëveshjeve të bashkëpunimit me organizata joqeveritare si Swiss Contact dhe kompani për gjetjen e mundësive dhe mbështetjen financiare të studentëve gjatë kohës së realizimit të intershipit apo dhe gjatë kryerjes së studimeve.

Adresa: “Rruga e Durrësit” Nr. 219 Tiranë

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)

Tel: +355 [04] 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

47

3. Tërheqja e stafit të ri ekspert në këtë fushë profesionale të rëndësishme për ekonominë shqiptare, sic është eficientia e energjisë në ndërtesa.
4. Futja në program e lëndëve si eficientia e sistemeve elektrike të përdorur në ndërtesa, e gjuhës së huaj profesionale apo matematikës që do të ndihmonte në kompletimin e njohurive në këtë fushë.
5. Puna e mëtejshme e stafit me përgatitjen e materialeve mësimore për këtë program studimi.

## **Conclusions of the Evaluation of the professional study program "Energy Efficiency", of the "POLIS" University**

### **Strengths and affirmations**


1. The importance and high demand for professional experts and expertise in this field enables students of the professional program in "Energy Efficiency" (EE) a rapid integration into the labor market.
2. The professional program in "Energy Efficiency" (EE) in POLIS UNIVERSITY is one of the first three programs of professional education in Albania and the first in the field of energy, that has undergone an accreditation process as a study program.
3. The realization of this study program in the framework of a European Erasmus program has enabled the creation of a modern laboratory dedicated for this study program. This laboratory has been further used for the courses and of continuous training of Energy Audit
4. Establishing a professional laboratory infrastructure, the modern HVAC laboratory enables students to develop practical competencies.

### **Weaknesses**

1. The full-time academic staff responsible for these study program, must carry a greater teaching load in order to meet the state standard of teaching load, where a minimum of 70% must be covered by the PAE.
2. For the professional school there is always a lack of problem related to special/professional literatures. More effort should be given for this program to enlarge the Albanian literatures.

### **Recommendations:**

1. To increase the marketing strategy for this program in way to boost awareness of stakeholders about the importance of possessing a professional diploma in this field.
2. Possibilities of establishing cooperation agreements with non-governmental organizations such as Swiss Contact and other companies in way to find opportunities for student financial support during the internship or during their studies.
3. Attracting new expert staff to be engaged in such an important field of expertise for the Albanian economy, such as energy efficiency in buildings.
4. The possibility to introduce to the program new related subjects such as the efficiency of electrical systems used in buildings and also foreign professional language or mathematics that would help complete knowledge in this field.



Two handwritten signatures in blue ink are present at the bottom right of the page. The first signature is on the left and the second is on the right, both appearing to be in cursive script.



5. Further work of the academic staff with the preparation of teaching materials for this study program.

**Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit**

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Përbushen përgjithësisht	Përbushen pjesërisht	Përbushen kryesisht	Përbushen plotësisht
<b>I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL</b>				X
<b>II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMEVE TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL</b>				X
<b>III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT</b>				X
<b>IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT DHE MBËSHTETJA E STUDENTËVE</b>				X
<b>V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE</b>				X
<b>VLERËSIMI TËRËSOR</b>				X

49

